



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 4 regjistër (JR)
Datë 02.02.2023

Nr. 52 i vendimit
Datë 08.07.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, ditën e martë, më datë 08.07.2025, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 4/2023 (JR), datë 02.02.2023, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Teuta Hoxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 587, datë 22.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Teuta Hoxha.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 42 dhe 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1 germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe jurisprudenca e kësaj gjykate; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe Kodi i Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e ngritura në ankim dhe parashtrime nga subjekti i rivlerësimit, i cila kërkoi çeljen e hetimit gjyqësor, prishjen e vendimit dhe urdhërimin e Komisionit/Këshillit të Lartë Gjyqësor të vijojë procesin e rivlerësimit edhe për dy kriteret e tjera dhe, si përfundim, ndryshimin e vendimit nr. 587, datë 22.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim

“Komisioni”) dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Teuta Hoxha, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, ushtronte detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për rrjedhojë, ajo u përfshi në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni administroi deklaratat dhe formularët e dorëzuar nga subjekti dhe raportet e hartuara nga organet ndihmëse, konkretisht deklaratën e pasurisë *vetting* dorëzuar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”)¹, sipas së cilave:

2.1. ILDKPKI-ja², në zbatim të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja³ ka informuar Komisionin se nuk disponohen të dhëna në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, znj. Teuta Hoxha.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 587, datë 12.11.2022, pasi konkludoi vetëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me shkaqet që vijnë:
 - 3.1. për apartamentin në përdorim në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;
 - 3.2. për apartamentin në Golem, subjekti dhe personat e lidhur kanë bërë deklarim të pasaktë sa i përket vlerës së deklaruar në deklaratën *vetting* dhe kanë mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën (-) 2.100.000 lekë për krijimin e kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016;
 - 3.3. për njësinë e shërbimit “zyrë”, në bulevardin “{***}”, Tiranë, subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, duke rezultuar me balancë

¹ Në aktet në fashikujt e përcjellë në Kolegj nga Komisioni, nuk administrohet raporti i KLGj-së, ndonëse në vendim referohet se është administruar. Sidoqoftë, hetimi administrativ për subjektin u mbyll bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë.

² Përcjellë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 16.10.2018.

³ Me shkresën e DSIK-së nr. {***} prot., datë 02.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH nr. {***}, datë 07.07.2020.

negative në vlerën (-) 6.355.782 lekë, sipas pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

4. Me vendimin e Komisionit, nuk është dakord subjekti i rivlerësimit, e cila ka ushtruar ankim brenda afatit ligjor. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit si për konstatimin për fshehjen ashtu edhe për mungesën e burimeve dhe ngre edhe pretendime që lidhen me procesin e rregullt ligjor. Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit paraqiten si vijon:

4.1. Për procesin e rregullt ligjor

(i) Subjekti pretendon se është deformuar qëllimi i ligjit, parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, pasi procesi i rivlerësimit të saj u mbyll bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë. Sipas subjektit, hetimi për një afat 3-vjeçar, tej çdo afati ligjor dhe të arsyes, përmbyllur vetëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, konstatoi vetëm: banesën në pronësi të vjehrrit të subjektit; një njësi me sipërfaqe 74,5 m² e blerë në rrugë bankare; si dhe një apartament modest me sipërfaqe 57 m², premtuar bashkëshortit të subjektit nga miku i tij i ngushtë i familjes, i deklaruar dhe i pa përfituar ende ligjërisht.

(ii) Në procesin e rivlerësimit është cenuar e drejta për jetë private e garantuar nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”). Ndërhyrja e Komisionit nuk ka ndjekur qëllimin e ligjshëm dhe ka tejkaluar nevojat e diktuar nga procesi. Kërkesa e pyetësorëve standardë të parapërgatitur, tejkalon objektin e ligjit, pasi detyron subjektet të bëjnë deklarime edhe pas momentit të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 duke i dhënë fuqi prapavepruese faktike.

(iii) Procesin cenoi parimin e sigurisë juridike dhe procesin e rregullt ligjor, pasi Komisioni deformoi të vërtetën duke fshehur faktet për të justifikuar publikisht fshehjen e pasurisë. Ky veprim cenon integritetin dhe figurën e subjektit me pasoja të pariparueshme, që duhet të adresohet drejt në Kolegj. Komisioni njeh disa të ardhura dhe, pas barrës së provës, rëndon balancën negative nëpërmjet vendimit të zbardhur pas analizës [pozitive] të dërguar nga subjekti. Komisioni anulon analizën e tij financiare të dërguar me rezultatet e hetimit, me qëllim që balanca nga pozitive të kthehet në negative, duke cenuar kështu thelbin e barrës së provës dhe sigurinë juridike.

(iv) Është cenuar procesi i rregullt ligjor, sipas nenit 6/1 të KEDNj-së, për shkak se njëra nga komisioneret, anëtare e trupës gjyquese të Komisionit, nuk plotëson kriteret e zgjedhshmërisë. Për pasojë, procesi nuk është zhvilluar nga një gjykatë e krijuar me ligj. Subjekti pretendon se erdhi në dijeni të këtij fakti pas vendimit të Komisionit. Shkarkimi nga detyra vendosur për të ishte rrjedhë e drejtpërdrejt e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit që shqyrtuan karrierën dhe jetën profesionale dhe familjare të saj në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën dhe me të vërtetën.

(v) Komisioni zhvilloi një procedurë formale për kriterin e pasurisë, duke zbatuar raportin e ILDKPKI-së. Edhe seanca dëgjimore ishte tërësisht formale, pasi nuk u morën në konsideratë dokumentet provues shtesë, si garancia hipotekore, që provon se apartamenti është në pronësi të vjehrrit, e që nuk është pasuri e fshehur e subjektit. Edhe fakti që Komisioni nuk pasqyron në vendim si provë shtesë një kontratë kredie, që shërbeu si burim i huadhënësit K. Ç., duhet të mbahet në konsideratë në drejtim të njëanshmërisë dhe formalitetit të seancës.

(vi) Vendimi i Komisionit është i paarsyetuar dhe bie ndesh me parimin e barrës së provës dhe kontradiktoriaritetit; vendimi pamundëson ankimin efektiv ndaj tij, me pasoja të rënda e të pariparueshme për një magjistrat.

4.2. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

(a) Për apartamentin në përdorim, me sipërfaqe 91 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti kërkon që: (i) marrëdhënia e përdorimit të mos trajtohet si fshehje pasurie. Ajo është përdoruese e pasurisë dhe jo pronare e fshehur e saj; (ii) në mesin e burimeve financiare që shërbyen për krijimin e kësaj pasurie të rillojariten të ardhurat që vjehrra përfitoi nga statusi i babait të saj, si i përndjekur politik dhe të përfshihet në analizë vlere 1.200.000 lekë, si e ardhur e vjehrrit nga marrëveshja e kaparit për shitjen e një sipërfaqeje prej 3.300 m², në vitin 2000.

(b) Për apartamentin në Golem, Durrës, me sipërfaqe 57 m², subjekti pretendon se ka shlyer vetëm 700.000 lekë në datën 21.04.2007. Pjesa tjetër iu shlye shitësit nëpërmjet shërbimeve të avokatisë nga personi tjetër i lidhur/bashkëshorti. Për të krijuar vlerën 700.000 lekë shërbyen të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit nga puna, për periudhën 01.01.2007-21.04.2007. Sipas praktikës së Kolegjit⁴, referuar tekstit alternativ të mundësisë financiare për burimet e ligjshme në dispozicion, kjo pagesë mund të konsiderohet e kryer në fund të vitit 2007, kur vërtetohet edhe mundësia financiare. Subjekti kërkon që të ardhurat e bashkëshortit nga avokatia për vitin 2007 të llogariten në vlerën 2.805.112 lekë, që përkon me 80% të fitimit nga aktiviteti përgjatë vitit 2007.

(c) Për pasurinë “njësi/zyrë” me sipërfaqe 74,5 m², ndodhur në bulevardin “{***}”, Tiranë, subjekti pretendon se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe e ushtrimit të një mbrojtjeje efektive, pasi duke mos dhënë arsye për refuzimin e provave, Komisioni i cenoj të drejtën për një ankim efektiv. Si burime të krijimit të pasurisë, në analizën në Kolegj duhet të përfshihen: (i) të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit në vitet 2006, 2007 dhe 2008; (ii) të ardhurat e kunatit, nga puna në emigracion përgjatë viteve 1999 – 2003, si dhe të ardhurat nga puna në Bankën {***}, nga prilli i vitit 2005 e në vijim; (iii) vlere 10.000 euro e dhënë nga z. K. Ç., që përfaqësonte parapagim të shërbimeve të avokatisë së bashkëshortit të subjektit; dhe (iv) huaja në shumën 7.980 GBP, dërguar në rrugë bankare nga z. A. M..

4.3. Në datën 16.06.2025, subjekti i rivlerësimit dërgoi në Kolegj parashtrimet e saj me shkrim. Në këto parashtrime, subjekti i qëndroi në tërësi pretendimeve të ngritura në ankim, ndërsa ka dërguar edhe një certifikatë pronësie, të pasurisë në Golem në emër të bashkëshortit të saj, lëshuar pas vendimit të Komisionit.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin e subjekteve të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Teuta Hoxha, bën pjesë në

⁴ Subjekti referon vendimin e Kolegjit (JR) nr. 37/2021, pg. 10.25., që i përket subjektit të rivlerësimit Sokol Ngresi.

juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankueses*

6. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegj*

7. Si rregull, në kushtet që vendimi objekt shqyrtimi është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit, gjykimi i çështjes në Kolegj zhvillohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh. Përjashtimisht, çështja mund të gjykohet në seancë gjyqësore [publike] në përputhje me nenin 51⁵ të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), kur Kolegji konstaton se: (a) duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja për konstatimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike; (b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelle të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; dhe (c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë.

7.1. Me ankimin, subjekti ka bashkëlidhur disa akte⁶. Rezulton se vetëm një prej tyre përbën akt të ri, ndërsa të tjerët janë administruar në Komision dhe analizuar e janë pjesë e analizës në vijim, në funksion të themelit të shkaqeve të ankimit⁷. Pretendimi i subjektit se Komisioni nuk i citoi aktet që lidhen me të ardhurat e këtij huadhënësi në vendim është i pakuptimtë në kushtet që këto prova arsyetohen shprehimisht në vendim, në paragrafët 11.77 – 11.86⁸. Për rrjedhojë, duke qenë pjesë e fashikullit, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të panevojshme t’i rimarrë këto akte në cilësinë e provës edhe njëherë.

7.2. Akti i ri, i sjellë me ankimin – librezë e kursimit në emër të vjehrrës së subjektit, lëshuar nga Dega e Bankës së Kursimeve Burrel në vitin 1996 – sipas subjektit, provon përfitimin e shumës 240.000 lekë në vitin 1996, për shkak të statusit të saj [vjehrrës] si trashëgimtare e një të përndjekuri politik. Nëpërmjet tij, subjekti argumenton që në analizën e të ardhurave të disponuara nga vjehrra të përllogaritet vlera 400.000 lekë, për efekt të burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e *apartamentit* në pronësi të vjehrrit të saj. Subjekti pretendon se e ka pasur të pamundur ta sjellë këtë akt më parë për disa shkaqe. Konkretisht, ajo shprehet se e ka gjetur librezën vetëm pasi është njohur me vendimin e Komisionit, ndërsa në periudhën e ndërmjetme, duke filluar nga gushti i vitit 2022, vjehrra ka pasur komplikime shëndetësore [humbi aftësinë e të folurit].

7.3. Nga analiza e sa më sipër, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit, për pamundësinë e paraqitjes së këtij akti që gjatë

⁵ I cili zbatohet nëpërmjet pikës 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

⁶ Aktet e reja me ankimin janë: (i) katër (4) certifikata noteriale për të ardhura të vitit 2007, 2008 dhe 2009 të z. A. M.; dhe (ii) fotokopje e noterizuar e një librezë kursimi në emër të vjehrrës së saj, që mban datën 26.03.1996, lëshuar nga Dega e Bankës së Kursimeve Burrel.

⁷ Aktet që lidhen me të ardhurat nga punësimi i personit tjetër të lidhur, z. A. M., në cilësinë e huadhënësit të shumës prej përrreth 8.000 GBP.

⁸ Shih edhe poshtëshënimin nr. 7 më sipër. Komisioni ka konstatuar që subjekti nuk ka deklaruar motrën e huadhënësit dhe të ardhurat e saj si burimin e huas, as në deklaratën vetting e as në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008.

procesit të zhvilluar në Komision, mbetën deklarative. Konkretisht, subjekti ka kërkuar dhe përfituar edhe kohë shtesë në përfundim të hetimit administrativ, për zëra të tjerë të ardhurash, efektivisht duke e shtyrë procesin nga mesi i tetorit 2022 deri në mesin e nëntorit 2022⁹, ndërkohë që me rezultatet e hetimit Komisioni ka vendosur një vlerë financiare të konfirmuar të pensionit të vjehrrës, sipas tabelës së përfshirë në faqen 5, që është shumë më e ulët sesa vlera që subjekti pretendon. Në këtë kontekst, subjekti ka pasur mjaftueshëm dijeni që ky zë të ardhurash ishte i paprovuar me dokumentacion që gjatë hetimit administrativ dhe në kushtet që procesi ka zgjatur deri në nëntor, mosparaqitja e këtij akti përpara ankimit nuk kapërcen kriteret e përcaktuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012¹⁰.

7.4. Mbi të gjitha, çfarë pretendohet se kjo librezë provon në terma kronologjikë – përfitimin përpara vitit 2001 të shpërblimit nga statusi i të përndjekurit të babait të vjehrrës -- bie ndesh me kohën kur ato janë lëvruar sipas akteve zyrtare të lëshuara nga Ministria e Financave, në vitin 2008. Pavarësisht nga sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë që Komisioni *nuk* është shprehur për mungesë burimesh në krijimin e apartamentit në rezultatet e hetimit, duke i kaluar subjektit barrë prove vetëm për të provuar se nuk përbën pasuri të *fshehur* të saj, edhe nëse pranohet ky akt, sikurse analizohet në vijim, të ardhurat që ai provon janë pa peshë në zgjidhjen e çështjes dhe ndryshimin e vendimit. Përpos dhe duke abstraguuar nga fakti që librezja e vitit 1996 nuk ka të dhëna që provojnë prejardhjen e fondeve apo të konfirmojë qoftë edhe indirekt një burim të caktuar të tyre, nga analiza alternative e kryer në Kolegj, vlera prej 240.000 lekësh nuk e ndryshon në mënyrë përcaktuese balancën negative që rezulton për burimet e ligjshme të disponuara për blerjen e apartamentit.

7.5. Si rrjedhojë, edhe parë në këtë këndvështrim, nën dritën e leximit të kombinuar të pikave 4 dhe 6, gerrat “a”, “b” dhe “d”, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016¹¹, edhe duke abstraguuar nga arsyet për të cilat subjekti nuk provoi pamundësinë për të sjellë këtë akt gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vlerëson se gjithsesi nuk konstatohen shkaqet ligjore për të çelur hetimin dhe shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit, për cilindo nga shkaqet¹² që parashikon neni 51 i ligjit nr. 49/2012. Në këto kushte, në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues vendosi të shqyrtojë ankimin e subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

⁹ Referuar paragrafëve 5 dhe 6 të vendimit të Komisionit. Subjekti ka kërkuar kohë shtesë për akte dhe prova nga Mbretëria e Bashkuar, më pas ka kërkuar edhe riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera. Ndonëse afati ishte 07.11.2022, subjekti dërgoi shpjegime dhe prova deri në datën 18.11.2022, të cilat u administruan dhe u analizuan nga Komisioni, ndërkohë që seanca dëgjimore u zhvillua në datën 10.11.2022 dhe vendimi u shpall në datën 22.11.2022.

¹⁰ “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

¹¹ “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. dhe “[6] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelitimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] a) marrja e provës duket se është e panevojshme; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit. [...]”.

¹² “[1.] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]”.

B. Vlerësimi i pretendimeve dhe shkaqeve të ankimit që lidhen me themelin e çështjes

B.I. Pretendimet për procesin e rregullt ligjor

8. Subjekti pretendon se është cenuar procesi i rregullt ligjor përcaktuar nga neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), për shkak se njëra nga anëtarët e trupës gjyquese të Komisionit, znj. Xh. P., nuk plotëson kriteret e zgjedhshmërisë e, për pasojë, procesi i subjektit nuk është zhvilluar nga një gjykatë e krijuar me ligj. Sipas subjektit, ajo u njoh me këto të dhëna *pas* vendimit të Komisionit. Shkarkimi nga detyra ishte rrjedhë e drejtpërdrejt e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit që shqyrtuan karrierën dhe jetën profesionale dhe familjare të saj në kundërshtim me ligjin, Kushtetutën dhe “me të vërtetën”.

8.1. Pa përsëritur sa është elaboruar në mënyrë shteruese rreth pretendimeve të kësaj natyre nga subjekte të tjera, edhe në çështjen konkrete, trupi gjyqës rikonfirmon arsyetimin e shtjelluar në vendime të mëparshme të Kolegjit për këtë aspekt¹³, në të cilat është konkluduar se përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit iu nënshtrua disa procedurave të mirëpërcaktuara në Kushtetutë [neni C i Aneksit të saj dhe në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016]. Për këtë arsye, duke abstraguar për ekonomi gjyqësore nga faza në të cilën ngrihet ky kërkim për herë të parë apo besueshmërisë së pretendimit për arsyet për të cilat subjekti ka zgjedhur ta parashtojë këtë pretendim vetëm *pas* vendimit të shkarkimit, trupi gjyqës çmon të zbatojë kriteret e elaboruara nga GjEDNJ-ja në *Ástráðsson* kundër Islandës dhe *Cani* kundër Shqipërisë.

8.2. Nën dritën e kësaj jurisprudence, trupi gjyqës i Kolegjit ka arsyetuar për¹⁴ qëllimin e legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t’i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. *Së fundmi*, trupi gjyqës mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNJ-ja¹⁵, trupi gjyqës i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit kryer në Kolegj.

8.3. Subjekti pretendon se *u deformua* qëllimi i ligjit, parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, pasi procesi i rivlerësimit të saj u mbyll bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë¹⁶. Sipas saj, hetimi për 3 (tre) vite është “tejt çdo afati ligjor dhe të arsyes” dhe referon si pa peshë konstatimet për të cilat është marrë masa disiplinore. Duke ngritur këndvështrimin e saj në formë pyetjesh në kontekstin e proporcionalitetit, duke potencuar qëllimin e ligjit, faktin që ajo dhe bashkëshorti së bashku kanë 50 vite punë dhe arsyet përse, sipas saj, analiza e dy kriterëve të tjera të rivlerësimit duhet të ishte kryer për të për efekt të një vendimi objektiv e proporcional.

¹³ *Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit (JR) nr. 43/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Hajrie Muçmata dhe (JR) nr. 3/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj.*

¹⁴ *Paragrafi 14.2.iv i vendimit të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit Hajrie Muçmataj.*

¹⁵ <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-206582> paragrafi 221, tek *Ástráðsson* kundër Islandës.

¹⁶ *Subjekti referon vendimin e Kolegjit (JR) nr. 20/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi.*

8.4. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim i subjektit është i pakuptimtë dhe i bazuar. *Së pari*, ky argument ka gjetur arsytim të zgjeruar, të konsoliduar e të përsëritur¹⁷ për të gjithë subjektet e rivlerësimit, që kanë zgjedhur ta potencojnë atë qysh në fillimet e procesit, apo sikurse subjekti¹⁸, edhe *pasi* GjEDNj-ja ka konfirmuar *përputhshmërinë* e procesit të rivlerësimit kryer mbi një kriter me garancitë konventore në çështjen *kyç* Xhoxhaj kundër Shqipërisë. Për këto arsye, si në çdo rast tjetër, trupi gjykues rikonformon që ligji nr. 84/2016 përcakton përtej çdo kontestimi se vendimi nga Komisioni e Kolegji mund të merret edhe bazuar në një kriter¹⁹. Në kushtet e moskalimit me sukses të njërit prej kritereve – sikurse ka ndodhur për subjektin e rivlerësimit – një rezultat pozitiv për dy kriteret e tjera nuk do të passillte asnjë ndryshim, pasi konfirmimi në detyrë kushtëzohet nga kalimi me sukses i të tri kritereve, nën dritën e nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

8.5. Në rrethanat konkrete, nga aktet në fashikull, rezulton se Komisioni, ndonëse nisi hetimin për të tria kriteret për subjektin, vendosi ta mbyllë atë bazuar vetëm në kriterin e pasurisë. Subjekti u njoh me provat, iu përgjigj pyetësorëve, si dhe paraqiti shpjegimet në përmbushje të barrës së provës. Pas kërkesës së subjektit për të hetuar edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, Komisioni është shprehur se provat deri në atë fazë kanë nivelin e provueshmërisë, sipas ligjit nr. 84/2016. Subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit me shpjegimet dhe provat e paraqitura. Në përfundim dhe pa hyrë në një vlerësim të themelit të vendimit, në kushtet që Komisioni konkludoi se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, shoqëruar me mungesë burimesh të ligjshme, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të argumentohet se ishte e nevojshme të hetohej për kriteret e tjera, pasi këto përfundime ishin të mjaftueshme teorikisht për të marrë masën disiplinore. Për të njëjtat arsye, edhe analiza për nëse shkarkimi ishte disproporcional nuk mund të gjente zbatim. Në parim, kjo analizë do të bënte kuptim nëse nga kontrolli i kriterit të pasurisë, Komisioni do të kishte konkluduar për problematika shumë të ndryshme – si për shembull -- të papërfillshme ose, të cilat, për shkaqe objektivistike të pakontestueshme, nuk mund t'i viheshin në ngarkim subjektit.

8.6. Në kushtet që gjitha pasuritë, për të cilat Komisioni ka konstatuar problematika janë krijuar *gjatë* kohës kur subjekti ishte në detyrë, janë deklaruar prej saj në deklaratën *vetting* dhe ajo ka një interes pasuror të qenësishëm me to, ky argument është i pabazuar në tërësinë e tij. Konkretisht, subjekti ka filluar stazhin si magjistrate në shtator 1999, është emëruar gjyqtare në shtator 2000 dhe ndërkohë ajo dhe bashkëshorti rezultojnë të martuar dhe janë bërë me fëmijë më 18.06.1999. Objekt i kontrollit në rivlerësim janë të gjitha pasuritë e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur. Apartamenti ku ajo jeton është blerë nga familja e bashkëshortit në vitin 2001, kur subjekti i rivlerësimit ishte emëruar gjyqtare në Tiranë. Edhe pasuritë e tjera janë krijuar pas martesë. Për rrjedhojë, përpjekja e subjektit për të paraqitur një situatë që e distancon nga krijimi i pasurive, duke ia atribuar gjithë veprimet bashkëshortit e familjarëve të tij, u vlerësua si synim për të krijuar *a prima facie* version që ngjason me rrethanat faktike të konstatuara nga GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari* kundër Shqipërisë. Nga ana tjetër, në kushtet që gjithë pasuritë janë krijuar pas martesë dhe gjatë detyrës, nuk gjen vend analiza për proporcionalitet.

¹⁷ *Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit (JR) nr. 3/2018 që i përket subjektit të rivlerësimit Fatos Lulo, paragrafi 17; dhe (JR) nr. 9/2023 që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, paragrafi 15.8.*

¹⁸ *Xhoxhaj kundër Shqipërisë ka hyrë në fuqi më 31.05.2021. Ankimi i subjektit Teuta Hoxha është pranuar në Komision më 26.01.2023.*

¹⁹ *Neni 4 pika 2, fjalía e dytë përcakton që: “[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave. [...]”.*

8.7. Vendimi i Komisionit është bazuar në konstatimin e situatës së fshehjes në emër të vjehrrit të apartamentit në përdorim të subjektit për një periudhë 20-vjeçare; të mungesës së burimeve të ligjshme në masën (-) 6.355.782 lekë për njësinë e shërbimit “zyrë” dhe (-) 2.100.000 lekë për apartamentin në Golem, Durrës. Balancat negative shumë të lartë, shoqëruar me konstatimin e dyshimet e fshehjes së pasurisë, janë elementë që e përjashtojnë zbatimin e parimit të proporcionalitetit të masës²⁰. Në këto kushte, pretendimi për cenim të dispozitës së nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 apo të parimit të proporcionalitetit është i pabazuar, sikurse edhe vendimmarrja e Komisionit, për të mos hetuar për dy kriteret e tjera, nuk cenon elementet e procesit të rregullt ligjor dhe as dikton situatën në të cilën do të duhet të gjente zbatim pika 1 e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.

8.8. Hetimi nga Komisioni, që sipas subjektit ka zgjatur për 3 (tre) vite, *tej çdo afati ligjor dhe të arsyes*, është një pretendim/*konstatim* që ngrihet për herë të parë vetëm në ankim dhe i pabazuar në akte dhe në ligj. *Së pari*, afati është shtyrë të paktën dy herë me kërkesë të subjektit për dorëzim të dokumentacionit. Nga aktet në fashikull rezulton se ndonëse çështja e subjektit u shortua në datën 15.12.2019 dhe Komisioni nisi kërkesat për informacion institucioneve të ndryshme në datën 08.01.2020, pyetësorët dhe ndërveprimi i mirëfilltë me subjektin ka nisur *vetëm në qershor 2022*, ndërsa vendimi për të është marrë në nëntor 2022²¹, më pak se gjashtë muaj. Nga ana tjetër, në ankimin në Kolegj, subjekti është shprehur se *rezervonte* të drejtën e paraqitjes së disa dokumenteve, kërkesë që nuk duket të jetë konsistente me kontestimin e potencuar prej saj për tejzgjatje të hetimit për “tre vjet”, pasi nënkupton në të njëjtën kohë se koha që ka pasur në dispozicion do të duhet të ishte më e gjatë.

8.9. Nga ana tjetër, ligji nuk përcakton një kohë të caktuar për kryerjen e hetimit administrativ nga Komisioni, dhe as subjekti nuk rezulton të ketë parashtruar përpara ose gjatë hetimit administrativ kundërshti për faktin që procesi *efektivisht* filloi mbi dy vjet më pas, në qershor 2022, sikurse edhe as të ketë argumentuar për nevojë për kohë shtesë përtej asaj që i është dhënë nga Komisioni apo në tërësi të ketë argumentuar se po veprohej me afate të paarsyeshme për procesin e saj të subjektit. Këtë pretendim, subjekti e ngrihet për herë të parë në ankim dhe nga përmbajtja duket se ka për fokus zgjidhjen e çështjes nga Komisioni dhe jo kohëzgjatjen e procesit.

8.10. Subjekti pretendon se në procesin e rivlerësimit të saj është cenuar e drejta për *jetë private* e garantuar nga neni 8 i KEDNj-së. Sipas subjektit, ndërhyrja e Komisionit nuk ndoqi qëllimin e ligjshëm dhe tejkaloi nevojat e diktuar nga procesi. Komisioni ka kryer një hetim administrativ nëpërmjet pyetësorëve paraprakë të parapërgatitur, të cilët, sipas saj, duhet të konstatohet si në tejkalim të ligjit. Subjekti pretendon edhe se Komisioni i detyron subjektet të bëjnë deklarime edhe pas momentit të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, duke i dhënë fuqi prapavepruese faktike këtyre deklarimeve. Pavarësisht se ktheu përgjigje dhe dërgoi prova për të mbështetur deklaratimet, të cilat iu referohen anëtarëve të familjes së bashkëshortit, madje një prej të cilëve ishte edhe i mitur, subjekti pretendon se Komisioni nuk citon asnjë të dhënë/provë në vendim. Sipas subjektit, nga njëra anë, nëpërmjet pyetësorëve, në emër të ligjit, Komisioni e

²⁰ *Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 1/2023, pg. 17.4. që i përket subjektit të rivlerësimit Andi Civici; vendimin e Kolegjit (JR) nr. 9/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, pg. 15.9.*

²¹ *Konkretisht, subjekti ka marrë pyetjet e para në datën 08.06.2022, u përgjigj në datën 17.06.2022, dhe dërgoi dokumentacion edhe në datat 19.07.2022, dhe 13.09.2022. Në datën 12.10.2022, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit, për të cilat u përgjigj në datën 31.10.2022. Në datat 07 – 09.11.2022 subjekti vijoi komunikimin me Komisionin dhe dërgimin e dokumentacionit plotësues. Në datën 10.11.2022, u zhvillua seanca dëgjimore, por pavarësisht kësaj, në datën 18.11.2022 subjekti dërgoi dokumentacion në Komision (që Komisioni e pranoi dhe e mori në shqyrtim). Vendimi u shpall në datën 22.11.2022.*

detyroi të deklarojë rrethana që kanë të bëjnë me jetën familjare dhe jetën private, dhe nga ana tjetër refuzoi qoftë edhe citimin e provave të paraqitura, duke deformuar thelbësisht procesin e rregullt ligjor.

8.11. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim është i pabazuar. *Së pari*, neni A i Aneksit të Kushtetutës ka parashikuar disa kufizime të disa të drejtave që lidhen me respektimin e jetës private²² për subjektet që zgjedhin t’i nënshtrohen këtij procesi *ex officio*. Kjo normë e vendosur për efekt të rivlerësimit kalimtar i është nënshtrohet qoftë kontrollit të përputhshmërisë me garancitë konventore, kushtetuese, por edhe zbërthimit të tyre në jurisprudencën e GjEDNj-së²³. Për rrjedhojë, në nivel parimor nuk gjen vend kontestimi për cenim të jetës private, në kuptim të nenit 8 të KEDNj-së, në hetimin e një pasurie të deklaruar në deklaratën *vetting* e që i nënshtrohet kontrollit për efekt të procesit. Sikurse është elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, por konfirmuar edhe nga kontrolli i kryer nga GjEDNj-ja nëpërmjet çështjes kyç të rivlerësimit, *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë, masa disiplinore e shkarkimit parashikuar nga ligji shqiptar nuk është disproporcionale dhe as në shkelje të parimeve të nenit 8 të Konventës²⁴.

8.12. Shkarkimi nga detyra për të/subjektin është marrë bazuar në konkluzionin se ajo ka kryer deklaram të pasaktë, ka mungesë burimesh dhe ka fshehur pasurinë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Nga kontrolli i vendimit, ashtu sikurse edhe i procedurës së ndjekur, aplikuar në çështjen objekt shqyrtimi, sipas kuptimit të nenit 8 të KEDNj²⁵, në tërësi apo në aspekte të veçuara, nuk rezulton që Komisioni të ketë ndërhyrë në ndonjë mënyrë në jetën private të subjektit apo të familjareve të saj. Gjithashtu, nuk konstatohet as që subjekti të jetë ngarkuar me një barrë disproporcionale gjatë kryerjes së hetimit administrativ. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës sipas dokumentacionit të administruar. Gjatë hetimit administrativ, subjekti nuk rezulton të ketë argumentuar se ndonjë apo disa prej kërkimeve e pyetjeve të Komisionit përbënte tejkalim disproporcional e të pajustificuar të tagrave, cenim të të drejtës për jetë private apo se u ngarkua me barrë disproporcionale.

8.13. Pretendimi se Komisioni iu dha fuqi prapavepruese përgjigjeve të saj (nëpërmjet pyetësorëve) apo që hetimi administrativ nëpërmjet pyetësorëve të parapërgatitur është në tejkalim të ligjit është, po ashtu, i pakuptimtë. *Së pari*, pyetësorët përpos atij standard janë të përshtatur me rrethanat dhe pyetjet që rezultojnë nga përgjigjet dhe deklaramet konkrete të subjekteve. Ndonëse rezulton që Komisioni ka dërguar pyetësorin standard, pasi i kishte dërguar subjektit një pyetësor më të detajuar më herët, ky fakt në vetvete dhe i vetëm, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, nuk tregon se subjektit i janë cenuar të drejtat për proces të rregullt. Për sa kohë Komisioni i ka marrë në konsideratë edhe përgjigjet e subjektit në pyetësorin standard dhe konkluzionet në rezultatet e hetimit dhe në vendim janë një ndërthurje e analizës së gjithë përgjigjeve, vonesa në dërgimin e pyetjeve standarde nuk rezulton të ketë pasur pasojë negative për subjektin.

²² “[1.] Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “f”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

²³ Referuar Opinioni nr. CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias, vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe arsyetimit të GjEDNj-së në paragrafin 402 të vendimit *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë.

²⁴ Shih paragrafin 402 dhe 403 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë.

²⁵ (1) Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. (2) Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

8.14. Pa përsëritur sa është theksuar më sipër, mënyra sesi kryhet hetimi nga Komisioni ka kaluar disa kontrole të përputhshmërisë me garancitë kushtetuese e konventore. Deklarata e pasurisë/deklarata *vetting*, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, përfshin deklarinimin e të gjithë pasurive të krijuara, të cilat i nënshtrohen kontrollit të organeve të rivlerësimit. Nëse Komisioni nuk do të kryente procesin nëpërmjet një ndërveprimi të mirëfilltë dhe efektiv me subjektet e rivlerësimit, që mundëson pjesëmarrjen efektive të tyre në proces, e do të mbështetej kryekëput në deklaratën *vetting* dhe në aktet e përcjella me të – sikurse duket të jetë në esencë pretendimi i subjektit – organet e rivlerësimit do të kryenin një konfirmim të raportit të organeve ndihmëse, që nga ana tjetër bie ndesh me detyrimin për të kryer hetim të pavarur e të thellë, parashikuar nga ligji dhe elaboruar më tej nga Gjykata Kushtetuese²⁶, më së paku.

8.15. Subjekti pretendon se procesi cenoi parimin e *sigurisë juridike*, pasi Komisioni deformoi të vërtetën duke fshehur faktet për të justifikuar publikisht fshehjen e pasurisë. Sipas subjektit, ky veprim cenon integritetin dhe figurën me pasoja të pariparueshme, që duhet të adresohen drejt në Kolegj. Subjekti pretendon se Komisioni njeh disa të ardhura dhe pas barrës së provës rëndon balancën negative nëpërmjet vendimit të zbardhur, pavarësisht analizës [pozitive] të dërguar prej saj. Subjekti, po ashtu, pretendon se Komisioni anulon analizën e tij financiare të dërguar me rezultatet e hetimit, me qëllim që të kthehet balanca nga pozitive, në negative, duke cenuar kështu thelbin e barrës së provës dhe sigurinë juridike.

8.16. Edhe ky pretendim është i pabazuar dhe sërish i pakuptimtë, pasi në thelb subjekti konteston konkluzionin e Komisionit dhe jo veprime që dëshmojnë apo kanë përbërë fshehje të provave. Nga kontrolli i vendimit të Komisionit, trupi gjykues nuk konstaton të jenë fshehur provat e dërguara nga subjekti, të cilat në fakt kanë marrë përgjigje. Në kushtet që aspektet e themelit për secilin vlerësim të kryer nga Komisioni shtjellohen gjerësisht në vijim, për efekt të kësaj pjese të analizës trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që Komisioni ka analizuar dhe konkluduar për provat e sjella nga subjekti për të ardhurat e një huadhënësi në paragrafin 11.83, faktin që apartamenti në Tiranë ku ajo jeton është në fakt pronë e regjistruar në emër të vjehrrit apo kontratën e kredisë bankare të personit tjetër të lidhur në paragrafin 11.70-11.76. *Së dyti*, edhe në kontekstin e balancave negative, pretendimi i subjektit është haptazi i pakuptimtë, në kushtet që balanca negative e subjektit ishte përkatësisht (-) 8.852.264 lekë me rezultatet e hetimit, kundrejt (-) 8.455.782 lekë në vendim ose thuajse 400.000 lekë më pak.

8.17. Pretendimi i subjektit duket se lidhet me një analizë të kryer prej saj e të dërguar në Komision. Në kushtet që kjo analizë nuk mund të argumentohet se ishte e detyrueshme për t'u marrë në konsideratë nga Komisioni dhe ka të njëjtën vlerë provuese si gjithë shpjegimet e tjera, edhe parë nën këtë dritë, ky pretendim është i pabazuar. Në linjë me arsyetimin e shtjelluar më sipër, edhe pretendimi se Komisioni zhvilloi një procedurë formale, pasi vetëm zbatoi raportin e ILDKPKI-së, nuk qëndron, por edhe bie ndesh me pretendimet e arsyetuara më sipër të subjektit me fokus kundërshtimin e hetimit administrativ të kryer nëpërmjet pyetësorëve. E thënë ndryshe, subjekti nuk është dakord qoftë me faktin që Komisioni ka *kryer hetim* – meqenëse sipas saj, përgjigjeve në pyetësorë u janë dhënë “fuqi prapavepruese” [shih paragrafin 8.13] – ashtu edhe me atë që sipas saj përbën *mungesë hetimi* – meqenëse konkluzioni i Komisionit është në linjë me ILDKPKI-në.

8.18. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues çmon të potencojë se mënyra sesi Komisioni vlerëson rrethanat është ushtrim i diskrecionit të tij dhe i nënshtrohet kontrollit të Kolegjit.

²⁶ *Neni 179/b pika 6 e Kushtetutës, apo vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 45 etj., në: <https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/vendime-perfundimtare-2017/>.*

Ndarja e një qëndrimi të ndryshëm është alogjike t'i atribuohet "fshehjes" së akteve apo një veprimi të paligjshëm, edhe duke abstraguuar nga fakti që arsyet që e kanë çuar Komisionin në konkluzionin për fshehje janë arsyetuar apo edhe thjesht fakti që fshehja e një pasurie përkufizimisht nënkupton *de jure* një pronar të ndryshëm. Komisioni/Kolegji i vlerëson provat në pajtueshmëri të dukshme me aktet e tjera dhe shpjegimet e subjektit dhe, nën dritën e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016²⁷, çmon çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. Fakti që konkluzioni në të cilin ka mbërritur Komisioni është në disfavor të subjektit dhe jep një cilësim të ndryshëm të marrëdhënies pasurore, ndër të tjera, nuk mund të argumentohet se barazohet/përbën fshehje të akteve.

8.19. Në dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së për procesin e rregullt ligjor, detyrimi i nenit 6/1 i Konventës për arsyetim në vendimet gjyqësore nuk mund të kuptohet se kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument apo provë nga gjykata²⁸. Mbi këtë bazë, mungesa e citimit të çdo prove individuale të depozituar nga subjekti në vendimin e Komisionit nuk mund të argumentohet si cenim i procesit të rregullt ligjor. Komisioni ka cituar aktet mbi të cilat ka mbështetur vendimmarrjen e tij, përfshirë edhe ato që i krijuan bindjen për konstatimin e fshehjes së pasurisë. Kjo analizë përmban arsye të mjaftueshme mbi të cilat subjekti të bazonte ankimin, duke siguruar në këtë mënyrë të drejtën për proces të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, pavarësisht se subjekti ndan qëndrim të ndryshëm, fakti që ajo ka qenë në gjendje të ushtronte ankim dhe parashtrime, duke i argumentuar kundërshtimet e saj në një material prej thujtase 130 faqesh, tregon se asaj i janë garantuar nëpërmjet arsyetimit edhe të drejtat kushtetuese e konventore për ankim.

8.20. Në të njëjtën linjë dhe nën të njëjtat dispozita ligjore e konventore me sa më sipër, u vlerësua i pabazuar edhe pretendimi se vendimi i Komisionit është i pakuptueshëm për shkak të mënyrës se si janë bërë llogaritjet, si dhe që procesi i kryer nga Komisioni është pavlefshëm dhe duhet përsëritur në Kolegji. Subjekti ka ushtruar ankim voluminoz që në vetvete nënkupton që vendimi i Komisionit nuk i ka mohuar këtë të drejtë dhe ka qenë mjaftueshëm i arsyetuar për t'i dhënë subjektit argumente për ta kundërshtuar. Komisioni ka pasqyruar provat që shërbyen si bazë mbi të cilën mori vendimin. Sikurse analizuar edhe më sipër, vendimi jo domosdoshmërisht duhet të citojë një për një të gjitha provat. Subjektit i janë drejtuar pyetje, i ka kaluar barra e provës në rezultatet e hetimit dhe ka marrë pjesë së bashku me avokatin në seancën dëgjimore. Pavarësisht nga afati i dhënë për datën 07.11.2022, ajo ka paraqitur prova dhe shpjegime të cilat i janë marrë në konsideratë edhe pas këtij afati, më 18.11.2022²⁹. Në vijim të disa korrektiveve, bazuar në shpjegimet dhe aktet e dërguara nga subjekti, balanca negative u ul, ndonëse jo në mënyrë përcaktuese. *Së treti*, edhe ky arsyetim i Kolegjit përbën materializim në terma praktikë të shërimit e plotësimit të arsyetimit të kryer në Komision, përfshirë edhe korrektimet e arsyetuara në vijim.

8.21. Për sa më sipër, rezulton se procesi i hetimit administrativ për subjektin është kryer në respektim të garancive kushtetuese e konventore për një proces kontradiktorial. Ajo ka parashtruar akte dhe shpjegime. Komisioni ia nënshtroi aktet analizës dhe me rezultatet e hetimit i dërgoi subjektit edhe analizën financiare tabelare, për të cilën ajo ka dhënë shpjegime, dhe ka

²⁷ 4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit i bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

²⁸ *Van de Hurk kundër Holandës*, § 61; *García Ruiz kundër Spanjës [GC]*, § 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës (déc.)*; *Perez kundër Francës [§8]*, *Francës Paragrafi 239*, udhëzuesi i nenit 6 të KEDNj-së, e drejta për proces të rregullt ligjor, seksioni civil: <https://rm.coe.int/1680700aaf>.

²⁹ *Shih edhe paragrafin 7.3 dhe poshtëshënimin nr. 9.*

paraqitur pretendimet për vlerat e vendosura nga Komisioni duke kundërshtuar në mënyrë të shprehur disa zëra të analizës financiare. Madje, në shpjegimet e rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur edhe tabela me ndryshimet që ka kryer vetë, çka nënkupton se e kuptoi tabelën e analizës financiare dhe metodologjinë e Komisionit. Konkretisht: në shpjegimet e rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se *në analizën e raportit nuk janë përfshirë*: të ardhurat nga dëmshtëpërblimi i ish të përndjekurve politikë; të ardhurat e vjehrrës nga pensioni i veçantë në vlerën 273.822 lekë; të ardhurat nga qiraja e tokës në vlerën 30.000 referuar kontratës së datës 01.07.2000; të ardhurat nga kontrata e kaparit në vlerën 1.200.000 lekë; të ardhurat nga punësimi i vëllait të bashkëshortit në Angli; shpenzime e tij të jetesës; të ardhurat nga pensionet e prindërve (subjekti shprehet edhe: *konstatohet se nuk janë përfshirë pensionet e prindërve për vitin 2001*).

8.22. Nga ana tjetër, Komisioni e ka lidhur secilin konkluzion me dispozitën e aplikueshme ligjore, duke konstatuar përkatësisht se subjekti gjendet në kushtet e pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “b” dhe “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për tre pasuri të paluajtshme, pasi ka mungesë burimesh për krijimin e dy prej tyre dhe që apartamenti në përdorim është në fakt pasuri e fshehur e saj dhe personit të lidhur. Komisioni ka shprehur edhe balancat negative të burimeve të ligjshme në momentin e krijimit të këtyre pasurive dhe të ardhurat që nuk janë përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara³⁰. Komisioni ka arsyetuar në vendim rreth ndryshimit të burimeve që subjekti ka bërë pas dërgimit të rezultateve të hetimit, rreth mungesës së deklaramit të gjendjeve *cash* jashtë sistemit bankar, për të ardhurat e bashkëshortit nga shërbimet ligjore në shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK., sikurse edhe mungesën e besueshmërisë së deklaramit të subjektit për huan nga një prej personave të tjerë të lidhur [z. A. M. nga e motra]. Në këtë mënyrë, Komisioni ka arsyetuar, përse konkludoi se subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë rezultuar në një pamundësi në vlerën (-) 6.355.782 lekë, sipas pikave 1 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, edhe në këtë këndvështrim, pretendimi i subjektit për mungesë të arsytimit të vendimit u vlerësua i papabazuar në tërësi.

8.23. Trupi gjykues, pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër se përse një konkluzion i pafavorshëm nuk mund të argumentohet si fshehje aktesh apo faktesh, rithekson se edhe konteksti mbi të cilin subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për fshehje pasurie bie në kundërshtim me procesin e vendimmarrjes, qoftë në një gjykatë të zakonshme, sikurse edhe nga organet e rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Konkretisht, duke marrë shkas nga pretendimi i subjektit se konkluzioni i Komisionit nuk pasqyroi në vendim provat që subjekti çmon të rëndësishme, si gjyqtare me karrierë 23-vjeçare apo që i përket brezit të parë të Shkollës së Magjistraturës, kohëzgjatja e karrierës së subjektit apo konteksti në të cilin asaj i është mundësuar të ndjekë Shkollën e Magjistraturës janë pa peshë ligjore. Këto faktorë, gjithsesi, trupi gjykues i Kolegjit i mbajti në konsideratë.

8.24. *Së fundmi* dhe si *obiter dictum*, trupi gjykues vëren se Komisioni, jo vetëm nuk e ka diskriminuar apo paragjykuar subjektin, por përkundrazi e ka favorizuar. Konkretisht, referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni për gjithë periudhën e rivlerësimit, përpos tre pasurive, për të cilat është marrë masa disiplinore e shkarkimit me balancat negative për krijimin e secilës prej tyre, subjekti ka rezultuar me një bilanc negativ të akumuluar e të konsiderueshëm për disa vite³¹ në një total, më së paku, rreth (-) 3.700.000 lekë. Në kushtet që vendimi nuk është

³⁰ Konkretisht, Komisioni ka konstatuar se: (i) kunati i subjektit u gjend në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar huan (21.000 USD dhe 11.864 euro) e dhënë bashkëshortit të subjektit; (ii) subjekti nuk provoi me dokumentacion mundësinë e huadhënësit tjetër, z. K. Ç. për krijimin e vlerës 10.000 euro, dhe huadhënësin tjetër, z. A. M., nuk kishte mundësi financiare për dhënie e huas 7.980 GBP.

³¹ Vitet 2004, 2012, 2014, 2015 dhe 2016.

ndalur në këtë balancë negative të konsiderueshme, duke pasur parasysh që flitet vetëm për pesë vite, një prej të cilëve edhe i hershëm – viti 2004, Komisioni ka treguar efektivisht një qasje favorizuese ndaj subjektit.

8.25. Në përmbledhje të sa më lart, vendimi i Komisionit është marrë duke u zbatuar parimet e parashikuara nga ligji dhe Kushtetuta. Subjektit i janë respektuar të drejtat e parashikuara si kusht që një proces gjyqësor/administrativ të konsiderohet i rregullt dhe ligjor. Për arsyet e konkluduara më lart, pretendimet e subjektit që lidhen me aspekte procedurale të gjykimit dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor, trupi gjykues i Kolegjit i gjeti të pambështetura në prova e ligj.

B.2. Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë

B.2.1. Apartamenti në përdorim në rrugën “{***}”, Tiranë

9. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri, në përdorim, me detajet përkatëse në deklaratën *vetting*. Konkretisht, apartamenti deklarohet me sipërfaqe 91 m², në pronësi të vjehrrit të saj, blerë me kontratën noteriale të datës 10.04.2001, me çmim 1.950.000 lekë dhe burimet përkatëse³². Komisioni konkludoi se ky apartament është pasuri e fshehur e subjektit, për shkak se ka konstatuar se: (i) të afërmit e bashkëshortit të subjektit nuk kanë pasur burime të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, të cilën e ka përdorur për 20 vjet subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti; (ii) familjarët e bashkëshortit kontribuuan me të ardhurat e tyre, por nuk e përdorën apartamentin, madje, kunati i saj – kontribuuesi më i spikatur jeton në shtëpinë e të motrës, dhe mbi të gjitha figuron edhe si huadhënës i një vlere të konsiderueshme huaje dhënë bashkëshortit të subjektit për të blerë një zyrë në vitin 2008; (iii) kontrata me UKT-në është lidhur në emër të bashkëshortit të subjektit, ndërsa nga aktet rezulton se blerësi faktik i kësaj pasurie të paluajtshme/vjehrrit, banon në Burrel.

9.1. Në ankim, subjekti kundërshton vendimin e Komisionit, duke e cilësuar të gabuar konstatimin se përdorimi i apartamentit është marrëdhënie *huaje*. Sipas saj, përdorimi ishte pasojë e marrëdhënieve familjare³³. Bashkëshorti është mbajtës i thjeshtë i kësaj banese, sipas dispozitave materiale civile, pa të drejta tjetërsimi dhe raporti i saj me pasurinë në fjalë është për shkak të martesës. Detyrimi i saj i vetëm ligjor kufizohet vetëm në deklarinimin si adresë banimi dhe nuk kategorizohet si marrëdhënie interesi pasuror. Subjekti kundërshton cilësimin e vjehrrit si person *tjetër* i lidhur me të dhe referon disa vendime të Kolegjit për të potencuar që marrëdhëniet e posaçme nuk ka nevojë të formalizohet³⁴. Analiza e thelluar përbën tejkallim të ligjit. Jetesa në atë apartament erdhi edhe si nevojë e kursimit për arsimimin e djalit.

9.1.a. Sipas subjektit, Komisioni ka fshehur fakte të rëndësishme siç janë: (i) garancia hipotekore për kredinë e kunatit të subjektit; dhe (ii) jetesa me familjarët e bashkëshortit, që provojnë se subjekti dhe personi i lidhur nuk ishin pronarë të apartamentit³⁵.

³² “(i) Kontributet financiare të pjesëtarëve të familjes së vjehrrit, H. K.; (ii) të ardhurat nga puna ndër vite; (iii) shpërblime nga përfitimet e statusit të të përndjekurve politik.

³³ Subjekti referon vendimin e Kolegjit (JR) nr. 20/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Gentjan Osmani, pg. 63: “Kolegji gjithashtu vlerësoi se edhe mungesa e një kontrate formale dhurimi nuk përbën shkak për të vënë në dyshim ekzistencën e kësaj kontrate joformale, duke pasur parasysh marrëdhënien tejet të veçantë prind-fëmijë”.

³⁴ Subjekti referon vendimin e Kolegjit (JR) 7/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Shpëtim Kurti, pg. 94; vendimin e Kolegjit (JR) nr. 10/2022, që i përket subjektit Fatri Islamaj, pg. 14.16; dhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 18/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi, pg. 71.

³⁵ Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti referon vendimin e Kolegjit (JR) nr. 18/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi. Subjekti citon paragrafin 70: “[...] Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në

9.1.b. Nuk është i vërtetë konkluzioni i Komisionit se familjarët e bashkëshortit të saj kontribuan me të ardhurat e tyre për blerjen e kësaj pasurie. Në këtë apartament ka jetuar për një kohë të konsiderueshme e motra e bashkëshortit të subjektit, që ishte e mitur dhe motra tjetër që prej vitit 2002. Nga gushti i vitit 2003 deri në shkurt të vitit 2004, së bashku me familjen e subjektit, jetoi edhe kunati. Prindërit e bashkëshortit të subjektit qëndruan në këtë apartament sa herë që kishin probleme shëndetësore; në raste ngjarjesh familjare, apartamenti ishte në dispozicion të tyre, pavarësisht se ku ishin të regjistruar me gjendje civile. Anëtarët e familjes kishin më pak nevojë që të përdornin këtë apartament se familja e subjektit.

9.1.c. Subjekti kundërshton edhe konkluzionin e Komisionit për kontratën e energjisë elektrike dhe të ujit, që është në emër të bashkëshortit të saj. Sipas subjektit, ndryshimi i emrit në kontratë është bërë në vitin 2013 nëpërmjet një autorizimi të vjehrrit, si konsumator që përdor dhe paguan energjinë elektrike.

9.1.d. Subjekti pretendon se familja e bashkëshortit kishte mundësi të krijonte këtë pasuri me burime të ligjshme. Ajo kërkon që në mesin e burimeve të ligjshme që janë disponuar për krijimin e kësaj pasurie të përfshihen: (i) të ardhurat e vjehrrës nga statusi i babait të saj si i përndjekur politik, prej 400.000 lekësh përpara blerjes së apartamentit dhe 1.400.000 lekë, fituar nga vjehrra si letra me vlerë dhe nga pensioni i veçantë, përkundër vlerës 23.031 lekë që përfshiu Komisioni në analizë; (ii) vlera 273.826 lekë e përfituar në periudhën prill 1993 – qershor 1995, që sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 184/1994 “Për dhënien e kompensimit pasuror ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, janë marrë në periudhën në fjalë.

9.2. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndonëse subjekti i rivlerësimit është e paqartë për një sërë rrethanash që janë evidentuar edhe nga Komisioni në krijimin e kësaj pasurie, nga argumentet e subjektit, i vetmi problem i qenësishëm për konstatimin e fshehjes, mungesa e burimeve të ligjshme nga prindërit e vëllai i bashkëshortit, u vlerësua *disproporcionale* dhe, si e tillë, e pamjaftueshme për të konfirmuar cilësimin ligjor të fshehjes në këtë proces. Në këtë vlerësim, u mbajt në konsideratë koha e krijimit të pasurisë [në vitin 2001], pak muaj pasi subjekti ishte emëruar gjyqtare, dhe pa pasur shkaqe të logjikshme që të dëshmonin nevojën për pasqyrimin e pasaktë të marrëdhënies së saj me këtë pronë, sikurse edhe rrethana të tjera që tregojnë disa ndërthurje të interesave të familjes së origjinës së bashkëshortit mes tyre, dhe nevojën për përdorimin e tij edhe nga familjarët e tjerë – motrat e bashkëshortit, ndër të tjerë. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit konsideroi problematikat e tjera të pasurisë, shtjelluar në vijim, me rëndësi përcaktuese në zgjidhjen e çështjes. Analiza mbi të cilën u bazua ky konkluzion shtjellohet në vijim.

9.3. *Së pari*, subjekti ka qenë inkonsistente për mënyrën sesi e ka deklaruar marrëdhënien e saj me këtë pasuri. Në deklaratën e parë të pasurisë, atë të vitit 2003, subjekti e deklaroi vetëm si adresë banimi. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 20.10.2004, subjekti është përgjigjur se jeton me *qira* mujore 20.000 lekë në këtë apartament. Po ashtu, në deklaratat periodike për vitet 2004, 2005 dhe 2006, që përkojnë në kohë më pas pyetjes nga ILDKPKI-ja në tetor 2004, subjekti ka vijuar të deklarojë qiranë për këtë banesë dhe si adresa e saj. Çmimi ka ndryshuar përkatësisht nga 240.000 lekë në vit, në deklaratën e parë, në 200.000 lekë në vit në dy deklaratat e tjera periodike. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti e

kushtet kur subjekti i rivlerësimit, në mënyrë konsistente ka deklaruar pasurinë e paluajtshme në përdorim, nuk arrihet të provohet ndonjë përpjekje e tij për të fshehur këtë pasuri, me qëllim shmangien e kontrollit për shkak të procesit të rivlerësimit, megjithëse nuk rezulton që Komisioneri Publik të ketë ngritur ndaj subjektit ndonjë dyshim për ndonjë rrethanë që mund të çonte te hipoteza e një pasurie të fshehur të tij”.

deklaroi vetëm si adresë banimi apartamentin në fjalë. Në datën 03.06.2008, subjekti është thirrur përsëri pranë ILDKPKI-së dhe është pyetur lidhur me mungesën e deklarimit të detyrimeve të qirasë së banimit në deklaratën periodike të vitit 2007. Subjekti është përgjigjur se vijon të jetojë në të njëjtën shtëpi të deklaruar më parë, por për vitin 2007 e në vazhdim, në marrëveshje me familjarët, nuk paguan qira, pasi apartamenti është në pronësi të vjehrrit. Këtë adresë subjekti e deklaroi si banimi, deri në vitin 2009. Në vitin 2010 deri në vitin 2015 nuk deklaroi adresë banimi në deklaratat periodike. Adresa u deklarua në deklaratën periodike të vitit 2016, dorëzuar në datën 29.03.2017, ashtu sikurse edhe në deklaratën *vetting*. Përpos përdorimit, në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar edhe burimet e krijimit të pasurisë dhe të depozitonte dokumente bashkëlidhur kësaj deklarate.

9.4. *Së dyti*, qëndrimi i Komisionit për të kryer analizën financiare të burimeve të krijimit, pavarësisht nga vlerësimi i pasaktë për marrëdhënie huaje “të shtrirë në 20 vite” dhe të “paformalizuar” dhe thirrja në zbatim e pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016³⁶, është *i gabuar*. Pavarësisht nga ky vlerësim i pasaktë, në kushtet që Komisioni ka hetuar gjithsesi për fshehje pasurie, në pikën fundore arsyetimi nuk ka qenë i një peshe që do të zhvleftësonte në tërësi analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë. Për rrjedhojë, në linjë me orientimet e Kolegjit, për dallimin mes situatave kur do të hetohet pa u kushtëzuar nga cilësimi i një marrëdhënieje si person tjetër i lidhur me subjektet³⁷, trupi gjykues çmon të abstragojë nga shkakut i gabuar i referuar në vendimin e Komisionit, duke u fokusuar në pikën fundore në faktin që barra e provës që i ka kaluar subjektit në këtë rast nuk ka qenë disproporcionale.

9.5. Pretendimi i subjektit se ajo nuk është *as mbajtëse* e thjeshtë e kësaj pasurie, është po ashtu i pabazuar. Sikurse rezulton në mënyrë të pakontestueshme nga aktet, si dhe nga deklaratimet periodike e ato gjatë kontrollit të ushtruar në ILDKPKI, subjekti ka jetuar gjatë gjithë jetës së saj profesionale në këtë apartament në mënyrë të pandërprerë, nga momenti i krijimit të pasurisë në vitin 2001 e deri kur Komisioni të kryente hetimin administrativ e mori vendimin, për 21 vjet. Kjo pasuri deklarohet si banesa kryesore³⁸ e saj, e përdorur nga familja, më së paku deri në kohën kur Komisioni ka marrë vendimin në vitin 2022. Nga ana tjetër, fakti që sipas akteve të dërguara Komisionit vjehri e vjehrra, pronarët zyrtarë të apartamentit, vijnë të jenë të regjistruar si banorë të Burrelit, tregon që pretendimi i subjektit se bashkëshorti i saj është një mbajtës i thjeshtë është i pabazuar. Në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasuritë në përdorim të subjektit të rivlerësimit me të drejtë i janë nënshtruar kontrollit për të përjashtuar, ndër të tjera, dyshimet për fshehje pasurie.

9.6. Komisioni konkludoi se familjarët e bashkëshortit të subjektit ishin në pamundësi që të krijonin këtë pasuri, me një balancë negative prej (-) 1.089.631 lekësh. Komisioni përfshiu në analizë: (i) të ardhura nga pensioni i vjehrrit të subjektit; (ii) të ardhura nga pensioni dhe nga pensioni i veçantë i vjehrrës së subjektit; (iii) të ardhura nga qiraja e një toke në Burrel; (iv) të ardhura të bashkëshortit të subjektit; (v) të ardhura nga paga dhe papunësia e kumatit të subjektit; si dhe (vi) të ardhura të kumatit nga emigracioni në Britaninë e Madhe. Ndërkohë, në paragrafin

³⁶ Referuar në paragrafin 9.14 të vendimit të Komisionit: “Në rastin konkret rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj të kenë lidhur me këtë pasuri një marrëdhënie huaje të shtrirë në 20 vite, të paformalizuar. Për pasojë, subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, iu kërkua të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie”.

³⁷ Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit që i përkasin subjekteve të rivlerësimit D. Rreshka (JR) nr. 15/2019, F. Islami (JR) nr. 10/2022, R. Troci (JR) nr. 26/2019, A. Gjoni (JR) nr. 9/2020 dhe vijuar me vendimet në vijim, A. Civici (JR) nr. 1/2023, A. Nikolli (JR) nr. 30/2023, K. Omari (JR) nr. 41/2023, B. Lleshi (JR) nr. 37/2023, Naim Tota (JR) nr. 52/2023, Silvana Pani (JR) nr. 28/2023.

³⁸ Subjekti disponon prona të tjera, sikurse do të analizohet në vijim, një apartament në Golem, Durrës dhe një zyrë të bashkëshortit të saj në Tiranë.

9.17.1 të vendimit³⁹, Komisioni mbajti në konsideratë edhe deklaratën noteriale të kumatit, lëshuar në vitin 2004, sipas së cilës blerja e apartamentit ishte *kontribut i tij*. Sipas vlerësimit të Komisionit, në rast se analiza do të kryhej sipas këtij deklarami, pamundësia do të ishte edhe më e madhe.

9.7. Nga ana tjetër, Komisioni arsyetoi se nuk vërtetohet koha kur është marrë dhe pjesa takuese e përfitimit të vjehrrës së subjektit për shkak të statusit të të përndjekurit nga i ati i saj, dhe nuk përfshiu në mesin e burimeve financiare një pjesë të pretenduar si të disponuar në momentin e krijimit të kësaj pasurie. Analiza e Komisionit u krye në shkresat e Ministrisë së Financave atë të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore/Drejtoria Rajonale Dibër, përcjellë në Komision përkatësisht në datat 08.07.2022, 26.11.2020, 08.07.2022 dhe 02.02.2021. Nga këto akte rezulton se:

9.7.a. Në shkresën e Ministrisë së Financave, lëshuar në vitin 2010 [dërguar në Komision gjatë hetimit, në datën 08.07.2022], masa e përfitimit në të holla është specifikuar 400.000 lekë, ndërsa në formën e letrave me vlerë 1.440.000 lekë. Në shkresën e datës 26.11.2020, referohet se vjehrra e subjektit, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 714/2010, ka përfituar *vlerën 500.000 lekë*, e shpërndarë në masën 250.000 lekë, përkatësisht në vitin 2010 dhe 2013. Ndërsa në shkresën e mëvonshme të po këtij institucioni, në datën 08.07.2022, bashkëshorti i subjektit është informuar se nëna e tij, përfitoi në total vlerën 922.500 lekë, e shpërndarë në tri këste, përkatësisht në vitet 2010, 2013 dhe 2021.

9.7.b. Bashkangjitur shkresës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore/Drejtoria Rajonale Dibër [nr. {***} prot.], datë 02.02.2021, gjenden disa akte për caktimin e një pensioni shtesë për familjarët e gjyshit të bashkëshortit të subjektit si i dënuar politik. Konkretisht, prej tyre⁴⁰ rezulton se katër (4) familjarëve të tij u është caktuar pension shtesë për periudhën 31.12.1946-14.03.1954, në total 76.191 lekësh, për periudhën 14.03.1954 – 08.03.1957, numri anëtarëve të familjes është ulur në dy anëtarë dhe pensioni në total 22.822 lekë dhe, *së fundmi*, për periudhën 08.03.1957 – 16.02.1961, një anëtar përfitues 21.887 lekë. Nën vlerën prej 21.887 lekësh [e cila duket se është vlera totale e llogaritur me 462 lekë/muaj për 47 muaj⁴¹], gjendet e shënuar një shifër prej 152.922 lekësh, e paspecifikuar sesi është përlllogaritur apo cilës periudhë i referohet.

9.8. Në seancën dëgjimore, subjekti ka shpjeguar për Komisionin natyrën e këtyre të ardhurave, duke i specifikuar si në formën e një pensioni të veçantë⁴². Komisioni përfshiu vlerën 23.031 lekë në formën e të ardhurave nga pensioni i veçantë i vjehrrës, për periudhën prill 1993-qershor 1995, që u provua me dokumentacion. Nga ana tjetër, në analizën e pasqyruar në vendim nuk janë pasqyruar të ardhurat në vlerën 400.000 lekë, nga statusi i trashëgimtares së të përndjekurit politik, me arsyetimin se nuk provohet koha kur është marrë pjesa takuese.

9.9. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë zë të ardhurash është i bazuar. *Së pari*, VKM-ja nr. 184/1994, të cilës i referohet subjekti, parashikon se kompensimi do të kryhet *kryesisht* në letra me vlerë. Subjekti nuk ka provuar se rasti i vjehrrës së saj është trajtuar si përjashtim nga ky rregull, për të provuar përfitimin e një shumë në *cash* 200.000 lekë. Ky akt, më tej, parashikon edhe modalitetet për zbatimin, nëpërmjet privatizimit

³⁹ <https://www.aksedrejtisi.al/dokumenta/1686047020Vendimi-Teuta-Hoxha.pdf>

⁴⁰ Përkatësisht, vërtetimit të datës 02.04.1993, vërtetimit të datës 21.06.1995, dhe atij të datës 21.06.1995.

⁴¹ Numri i muajve për periudhën 8.3.1957-16.2.1961.

⁴² “ [...]të ardhura nga dëmshpërblimi i të përndjekurve politikë që [...] personat që kanë qenë të përndjekur politikë, kanë përfituar për shkak të këtij statusi, të ardhurat nga një pension i veçantë, [...] për shkak të moshës së tyre minore në momentin që kishin fituar këtë status, pra kishin ndodhur në kushtet e ekzistencës së këtij statusi [...]”.

me letra me vlerë kompensimi. Me fjalë të tjera, ky akt nënligjor, ndryshe nga sa pretendon subjekti, nuk provon përfitimin përpara vitit 2001 dhe as shumën e përfituar.

9.10. Po ashtu, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 714/2010, masa e dëmshpërblimit, me këste, do të paguhej në bankë. Në listën bashkëlidhur këtij vendimi, rezulton se dosja në emër të gjyshit të bashkëshortit është hapur në datën 24.09.2008 -- shtatë (7) vite pasi është blerë banesa, dhe vlerat e akorduara janë 400.000 lekë likuiditete dhe 1.440.000 lekë në letra me vlerë. Ky fakt dhe analizuar bashkë me shkresat e Ministrisë së Financave [referuar në paragrafin 9.7.a më sipër], që referon se pagesat u kryen duke nisur nga viti 2010, tregon se përpara kësaj date nuk provohet të jenë kryer kompensime. E thënë ndryshe, përfitimi në vitet 90', sikurse pretendon subjekti, nuk provohet. Të tria shkresat e Ministrisë së Financave i vendosin pagesat në vitet 2010 e pas.

9.11. Vërtetimet e referuara në pikën 9/7/b, ndonëse provojnë përcaktimin e një pensioni shtesë për familjarët e bashkëshortit të subjektit, nuk provojnë përfitimin e këtij pensioni përpara vitit 2001 dhe as pjesën takuese të vjehrrës së subjektit. Fotokopja e noterizuar e librezës në emër të vjehrrës, e dërguar nga subjekti me ankimin [përpos sa u analizua që nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë si provë e re në ankim] pavarësisht se pasqyron një datë të lëshimit, 26.03.1996, derdhje të vlerës 240.000 lekë, tërheqje 480 lekë, nuk pasqyron se çfarë përfaqësojnë këto vlera apo cila është prejardhja e tyre.

9.12. Për këtë arsye, trupi gjykues vëren se subjekti nuk arriti të provojë përfitimin për shkak të këtij statusi në nivel sasior dhe në kohën kur ajo pretendon. Edhe koha e përfitimit të dëmshpërblimit në letra me vlerë apo konvertimi në likuiditete përpara vitit 2001, nuk u provua. Pavarësisht dhe duke abstraguuar nga të gjitha këto konstatime, edhe në një analizë alternative që mundëson shterimin e të gjitha kërtimeve të cilat gjejnë mbështetje në prova të kohës⁴³, sipas së cilës përfshihen në analizë të ardhurat nga pjesa takuese e vjehrrës nga pensioni shtesë, përllogaritur në vlerën 205.268 lekë, balanca negative e përllogaritur në Komision, për krijimin e apartamentit në vitin 2001, do të zbutej në një vlerë të pamjaftueshme për ta përmbysur⁴⁴ për shkak të zërave të tjerë financiarë sikurse vijon.

9.13. Subjekti pretendon që në mesin e burimeve financiare të ligjshme të disponuara nga familja e bashkëshortit, të përfshihet edhe një shumë 1.200.000 lekë, nga shitja e një sipërfaqe toke në Burrel në vitin 2000. Për të provuar këtë pretendim, gjatë hetimit administrativ, ajo ka përcjellë një aktmarrëveshje me *shkrim dore*⁴⁵, të lidhur nga vjehri dhe bashkëshorti i saj dhe një blerës. Sipas kësaj marrëveshjeje, blerësi ka rënë dakord në datën 01.09.2000 që do t'i jepte vjehrit të subjektit 1.200.000 lekë si kapar. Subjekti ka dërguar edhe tri akte mbështetëse⁴⁶ dhe ka deklaruar se toka *nuk* mund të shitej pasi ishte në proces regjistrimi, i cili është kryer më 30.08.2019. Kontrata përfundimtare nuk ishte lidhur deri gjatë hetimit në Komision, për pamundësi të njërës prej anëtareve të familjes bujqësore që jeton në Itali.

9.14. Komisioni konkludoi se kontrata e kaparit/aktmarrëveshja për përfitimin e vlerës 1.200.000 lekë nuk u pasua me kontratën e shitjes. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk përmbushin

⁴³ Duke marrë në konsideratë që: (i) vërtetimet e viteve 1993 dhe 1995, provojnë caktimin e pensionit shtesë dhe depozitim në vlerë 240.000 lekë⁴³ në llogarinë e kursimit të vjehrrës së subjektit; (ii) kohën e gjatë që ka kaluar nga momenti i përfitimit të këtyre të ardhurave.

⁴⁴ Arsyetuar në vijim, si përmbledhje e zërave të analizës financiare në kontroll të përllogaritjes së kryer në Komision. Balanca negative, duke përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme edhe vlerën 205,268 lekë do të shkonte nga (-) 1.089, 631 lekë në (-) 1.041.767 lekë.

⁴⁵ Ky akt është njehsuar me origjinalin në datën 01.12.2020.

⁴⁶ AMTP-në, një mandatpagese si parapagim i vlerës 1.200.000 lekë dhe planvendosjen e dy sipërfaqeve 11.000 m² dhe 4.750 m².

kushtet e parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës e nuk u përfshinë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara në funksion të blerjes së pasurisë objekt analize në vitin 2001.

9.15. Në ankim, subjekti kërkon përfshirjen e kësaj vlerë në mesin e të ardhurave të familjes së bashkëshortit. Me të njëjtat argumente si në Komision, subjekti pretendon se gjendet në kushtet e pamundësisë së sigurimit të dokumentacionit të nënshkrimit të kontratës së shitjes, pasi në vitin 2019 vendi u godit nga tërmeti, më pas pandemia, ndërkohë që kunata, si anëtare e familjes bujqësore, jeton në Itali dhe nuk mund të vijë për të nënshkruar kontratën, pasi është me fëmijë të vegjël e, njëkohësisht në gusht të vitit 2022, vjehrra u sëmur, me pasojë humbjen e aftësisë së shprehjes së vullnetit.

9.16. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit për përfitimin e shumës në fjalë në vitin 2000 nuk janë në përputhje me aktet e tjera dhe kanë probleme besueshmërie. Për rrjedhojë, edhe në analizën e kryer në Kolegji, kjo shumë nuk u përfshi në mesin e burimeve të ligjshme që mund të këtë disponuar familja e bashkëshortit të subjektit në vitin 2001. *Së pari*, ky konkluzion mban në konsideratë *formën* e aktmarrëveshjes, e cila duke qenë me shkrim dore ngre pyetje të rëndësishme *më së paku* për kohën kur është hartuar. Vërtetimi i nënshkrimit gjatë vitit 2020 nuk sjell asnjë ndryshim në këtë drejtim, në kushtet që është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, edhe duke abstraguuar nga pyetje për vlefshmërinë e aktit për shkak të ndryshimeve ligjore⁴⁷. Për të njëjtat shkaqe, edhe mandatpagesa e depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ është e pamjaftueshme që të konsiderohet si akt i kohës. Përpos që i mungon një numër serial, mandatpagesa paraqet edhe problematika të njëjta me ato të identifikuar më sipër për aktmarrëveshjen.

9.17. *Së dyti*, aktmarrëveshja nuk gjen pasqyrim në ndonjë akt tjetër të kohës. Certifikatat e pronësisë së dy sipërfaqeve të tokës në emër të vjehrrit të subjektit [si përfaqësues i familjes bujqësore] nuk shoqërohen me kartela pasurie, për të verifikuar nëse ka ndonjë kufizim përdorimi – që do të hidhte dritë mbi ekzistencën e premtim shitjes që deduktohet nëpërmjet aktmarrëveshjes dhe kaparit. As sipërfaqja që referohet me aktmarrëveshje, 3.400 m², nuk pasqyrohet në planvendosjen që palët i bashkëlidhen aktmarrëveshjes, si dhe nuk pasqyrohet e ndarë nga sipërfaqet e regjistruara në emër të vjehrrit të subjektit. Po ashtu, as aktet e tjera zyrtare të administruara e hartuara ndër vite nuk kanë një referencë të kësaj aktmarrëveshjeje, sikurse për shembull: deklarata periodike e subjektit për vitin 2004, deklarata noteriale e kunatit të saj gjatë kontrollit nga ILDKPKI-ja⁴⁸ në tetor 2004 apo edhe në deklaratën *vetting* si burim i konkretizuar. Në këtë të fundit, subjekti deklaroi si burim të ardhura të pjesëtareve të familjes nga puna ndër vite dhe shpërblime nga përfitimet e statusit të të përndjekurit politik.

9.18. Mbi të gjitha, kjo panoramë e parashtruar nga subjekti nuk shpjegon përse palët nuk e kanë formalizuar këtë pagesë të kryer në një kohë më afër marrëveshjes dhe pagesës, sikurse as përse në 20 vite, blerësi nuk ka gjetur asnjëherë mundësinë apo nevojën të dokumentojë në një formë që i ofronte edhe atij siguri për njohjen dhe konfirmimin e shlyerjes së një pagese të konsiderueshme, ndërkohë që nga ana tjetër, deri në vitin 2022, 22 vite më pas, nuk posedon asnjë akt zyrtar të pronësisë. Kapari është mjete që siguron përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga kontrata kryesore. Edhe duke abstraguuar nga problemet e formës së aktmarrëveshjes, trupi

⁴⁷ Me ndryshimet që ka sjellë ligji nr. 9216/2004, nuk lejohet pajisja me “vërtetim nënshkrimi” për akte që nuk janë nënshkruar në prani të noterit.

⁴⁸ Arsyetuar në vijim; pasi është pyetur në 20.10.2004 në ILDKPKI për pasuritë që dispononte, subjekti ka paraqitur edhe një kontratë noteriale të kunatit [nr. {***}], që mban datën në 25.10.2004, ku ai deklarohet si blerësi i apartamentit objekt analize, me të ardhurat nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar.

grykues vëren se konkretisht subjekti pretendon një situatë sipas së cilës kapardhënësi, për periudhën rreth 19-vjeçare, nuk ka ngritur asnjë pretendim për përmbushjen e detyrimit. Për këto arsye, bëhet e pabesueshme të pranohet që blerësi zgjodhi thjesht t'i japë vjehrrit të subjektit vlerën 1.200.000 lekë në vitin 2000 dhe nuk u interesua më, qoftë për ecurinë e regjistrimit të pronës, qoftë për kalimin e pronës në favor të tij, ndonëse palët kanë rënë dakord që prona do të shitej me çmimin e tregut në momentin e hartimit të kontratës – kusht kontraktor që bie ndesh me logjikën financiare të blerësit nëse vlera e pronës ndryshon në proporcion të drejtë me kohën që kalon.

9.19. *Së treti*, ka një sërë rrethanash të cilat nuk përkojnë nga ana logjike dhe e bëjnë të pabesueshme kuadrin faktik që pretendohet edhe parë nga konteksti *i shitësve*. Konkretisht, është e paqartë dhe, për pasojë, dobëson besueshmërinë e pretendimeve të subjektit mosregjistrimi i këtyre pronave deri në datën 29.03.2019, kur pretendohet se vjehrrin e saj u angazhua me kërkesë. Për të njëjtat arsye, edhe pretendimi se anëtarët e familjes bujqësore nuk arritën të nënshkruanin kontratën e shitjes nga viti 2019 deri në vitin 2022 apo edhe kryerjen e veprimeve juridike nëpërmjet përfaqësimit për 22 vjet nuk janë bindëse. Pretendimi i subjektit se kunata nuk mund të udhëtonte nga viti 2019 deri në 2022, nga një vend fqinjë [Italia], ndërsa i vetëm mund të prezumohej i besueshëm, së bashku me aspektet e tjera, kontribuon në dobësimin e besueshmërisë. Subjekti nuk solli asnjë akt për të treguar pamundësinë e kunatës për të udhëtuar nga një vend fqinj për periudhën e pretenduar nga 2019-2022 apo më herët. *Së fundmi*, procesi i hetimit administrativ të subjektit nisi në qershor 2022, dy vite pasi ishin hequr kufizimet e lëvizjes ndërkombëtare dhe teorikisht pandemia nuk mund të përbënte në vijim shkak për pengesa për t'u paraqitur pranë noterit për të nënshkruar deri para se vjehrra e subjektit të sëmurej.

9.20. Për sa më sipër, edhe trupi grykues i Kolegjit e gjen të pabazuar kërkesën e subjektit për të përfshirë në analizën financiare vlerën 1.200.000 lekë. Krahasuar me burimet e deklaruara në deklaratën *vetting*, ky fond paraqitet si shtesë burimesh gjatë procesit të rivlerësimit ose si një element që paraqet përpjekje të subjektit për të përmirësuar situatën në hetim.

9.21. Zëri tjetër i analizës financiare i përket të ardhurave dhe shpenzimeve të jetesës *së kunatit* të subjektit [nga punësimi dhe qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar], për të cilat ajo kërkon korrigjimin duke përfshirë në analizë edhe një shumë prej 548.4 GBP, sipas një mandatpagese të muajit maj 2000. Ky akt është depozituar në Komision në përgjigje të rezultateve të hetimit. Komisioni ka konstatuar se të ardhurat për këtë periudhë kohore janë përfshirë në analizë tashmë, si rrjedhojë e një akti zyrtar⁴⁹, të sjellë më herët që mbulon periudhën prill 2000-prill 2001 e, për rrjedhojë, edhe majin e vitit 2000. Pranimi i këtij akti do të përbënte dublim të të ardhurave për muajin maj 2000.

9.22. Trupi grykues i Kolegjit konstaton se vlerësimi i kryer nga Komisioni është i bazuar. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, për burimet e ligjshme të disponuara nga ky punësim i kunatit, u përlllogarit vlera e pasqyruar në analizën e Komisionit.

9.23. Për sa i përket *shpenzimeve të jetesës*, përlllogaritur për kunatin e subjektit gjatë qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar, që subjekti i kundërshton si *tepër të larta* me arsyetimin se ai nuk ka pasur shpenzime, për arsye të ndryshme⁵⁰, trupi grykues vëren se Komisioni është bazuar në

⁴⁹ *Certifikatë [National Insurance Contributions] e pagesës së tatimit mbi të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve për vitin fiskal që mbaron në prill 2001 për A. K., me të dhëna nga punësimi në {***}, në shumën 10.587 GBP, dhe deduktime detyrimesh taksash 2.180,94 GBP.*

⁵⁰ *Sipas subjektit, kunati nuk ka pasur shpenzime jetese në Londër pasi në gjashtë mujorin e parë të qëndrimit shpenzimet janë mbuluar nga shteti; për periudhën mars 2000 e në vijim nuk kishte shpenzime akomodimi/qiraje*

referencën zyrtare të nivelit të varfërisë të publikuara nga EUROSTAT. Me fjalë të tjera, shpenzimet e përlogaritura janë në nivelet më të ulëta të përlogaritura dhe konfirmuara me akte zyrtare. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për të mospërdorur EUROSTAT-in apo për të mospërlogaritur asnjë shpenzim për sa kohë ka jetuar tek e motra, i pabazuar në akte dhe që bie ndesh me të vetmin burim zyrtar të disponuar, u vlerësua i pabazuar. Për këtë arsye, edhe në analizën e kryer nga Kolegji, njëjtë si në Komision, shpenzimet e jetesës gjatë qëndrimit të kunatit në Angli u konsideruan në nivelin e varfërisë sipas EUROSTAT-it.

9.24. Në Kolegj, u kryen disa korrigjime, që sollën një diferencë në analizën financiare të Komisionit, për shkak të kursit të ndryshëm të konvertimit të vlerave nga monedhës [GBP në lekë] dhe të shpenzimeve të jetesës së vjehrrës së subjektit, të cilat përpara viteve 2000, u përlogariten në nivelin e 66% të të ardhurave familjare. Nga këto korrigjime, pavarësisht nga zbutja, mbetet një balancë negative e mundësisë së blerjes së apartamentit në Tiranë në vitin 2001 krahasuar me atë të rezultuar në Komision, e konkretisht nga (-) 1.089.631 lekë të konstatuar në Komision në (-) 1.041.767 lekë në Kolegj.

9.25. Pasi analizoi edhe aspektet e tjera të rrethanave faktike që rezultojnë për përdorimin e kësaj pasurie, trupi gjykues vlerësoi se balanca negative e burimeve të ligjshme të familjes së origjinës së bashkëshortit mbetet aspekti më domethënës. Rrethanat e tjera që rezultuan nga shpjegimet e subjektit dhe aktet në fashikull, në balancën tërësore të gjithë elementëve kontrollues të kontrollit të kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se nuk janë të mjaftueshme për të konfirmuar domosdoshmërisht fshehje pasurie nga subjekti.

9.26. Konkretisht, nga njëra anë, subjekti ka qenë inkoherente për marrëdhënien konkrete të saj me këtë apartament dhe familja e bashkëshortit nuk kanë mundësi të krijojnë këtë pasuri me burime të ligjshme. Blerësi kryesor – sipas variantit të fakteve të pretenduar prej subjektit gjatë kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja në vitin 2004, kunati, pretendohet të ketë blerë një apartament për subjektin e bashkëshortin ndërkohë që ai vetë duhet të strehohej në shtëpinë e së motrës⁵¹. Vetëm në vitin 2011, nëpërmjet një kredie bankare prej 75.000 USD [bashkë me të motrën, znj. L. K.] kunati bleu një apartament të tijin. I njëjti kunat, shfaqet më pas sërish si kontribuues kryesor për investimin e subjektit e bashkëshortit në vitin 2008 në një njësi shërbimi, përpara se ai vetë të blinte shtëpi.

9.27. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se ka rrethana që tregojnë ndërthurje të interesave të familjes së origjinës së bashkëshortit të subjektit, me nevojën e përdorimit të kësaj pasurie prej tyre, ashtu sikurse edhe fakti që apartamenti u ble në prill 2001, më pak se një vit pasi ajo u emërua gjyqtare [në shtator 2000], sikurse edhe duke mbajtur në konsideratë kontratën e kredisë hipotekore të kunatit, sipas së cilës, apartamenti u vendos nën barrë për sigurimin e përmbushjes së saj apo edhe ndjekjen e shkollës së mesme nga motra e bashkëshortit në vitet 1999-2003, në Tiranë⁵², u vlerësuan si argumente të cilët nuk mund të mos ishin pjesë e analizës integrale të kryer për efekt të shterimit të të gjitha pyetjeve që ngre ky shkak ankimi. Për rrjedhojë, duke parë në tërësi të gjitha këto aspekte, trupi gjykues vlerësoi që zgjidhjen e çështjes ta bazojë në konkluzionet në vijim për kriterin e pasurisë.

pasi ka qëndruar në banesën e motrës; gjatë periudhës së punësimit të tij në disa hotele në qytetin e Londrës, ushqimi gjatë turneve ka qenë falas; kunati kishte një mënyrë jetese [prej emigranti], të ndryshme nga standardi i EUROSTAT-it.

⁵¹ *Sipas deklaratës noteriale të z. A. K. nr. {***} rep., datë 25.10.2004.*

⁵² *Referuar akteve në fashikull, shkresa e Arkivës Shtetërore Vendore, datë 10.08.2022 me nr. {***} prot., konfirmon shkollimin e mesëm në Tiranë në periudhën 1999-2003 të njëjës prej kunatave të subjektit pas ardhjes nga Burreli.*

10. Ky apartament është një ndër pasuritë e deklaruara në deklaratën *vetting*, blerë sipas aktmarrëveshjes së datës 21.04.2007, në vlerën 2.100.000 lekë me burim të ardhurat e saj dhe bashkëshortit nga puna përgjatë viteve 2005 – 2006. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka konkluduar se subjekti është gjendur në pamundësi të krijimit të kësaj pasurie në vlerën (-) 2.100.000 lekë, nuk përmbysi barrën e provës dhe shpjegimet e saj në hetimin administrativ dhe në ILDKPKI në vitin 2015, sipas të cilave ka paguar vetëm 700.000 lekë, ndërsa diferenca është shlyer në natyrë me shërbime avokatie nga bashkëshorti, janë pretendime deklarative dhe në kundërshtim me deklaratën *vetting*. Në këtë konkluzion, Komisioni mbajti në konsideratë deklaratat periodike vjetore të subjektit në periudhën pararendëse dhe specifikimin e kursimeve për blerjen e një pasurie tjetër [të analizuar në vijim] si burim. Po ashtu, Komisioni vlerësoi se disa shpjegime të subjektit për një “akt-rakordim” bien ndesh me dispozitat materiale civile, përveçse nuk janë pasqyruar ndryshimet në kontratën e premtim shitjes në vitin 2009.

10.1. Subjekti ka kundërshtuar në tërësi këtë konkluzion. Ajo argumenton se Komisioni gabon kur konkludon se aktmarrëveshja e vitit 2007 është në kundërshtim me kontratën e premtim shitjes së vitit 2009 dhe kërkon që Kolegji të kryejë analizën mbi bazën e saj [aktmarrëveshjes]. Sipas saj, përcaktimi i gjendjes së dyfishit të pasurisë së ligjshme si shkak shkarkimi, përcaktuar në pikat 3 dhe 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, është pranim nga ligjvënësi i mungesës së funksionimit të administratës tatimore. Në terma konkrete, subjekti pretendon se: (i) pagesa prej 700.000 lekësh për apartamentin, kryer në datën 21.04.2007, ka burim të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit nga puna për periudhën 01.01.2007 – 21.04.2007. Mosdeklarimi si burim në deklaratën *vetting* i të ardhurave të vitit 2007, por vetëm i atyre të viteve 2005 dhe 2006, përbën *harresë* diktuar nga ngarkesa në punë. Kursimet e përdorura për këtë pasuri i zëvendësoi brenda vitit. Për pasojë, nuk kishte detyrim deklarimi. Në kushtet e mungesës së përcaktimit të modaliteteve të pagimit të çmimit në aktmarrëveshjen e vitit 2007, referuar praktikës së Kolegjit në një vendim të mëparshëm⁵³, ajo [pagesa] mund të konsiderohet e kryer në fund të vitit 2007, ku vërtetohet edhe mundësia financiare. Subjekti, po ashtu, kërkon të korrigjohen: (ii) të ardhurat e bashkëshortit nga avokatia për vitin 2007, sipas saj janë 2.805.112 lekë, ekuivalenti i 80% të fitimit mbi vlerën 3-4 milion lekë, sipas një shkresë të Drejtorisë së Tatimeve Vendore dhe jo 2.400.000 lekë si në analizën e Komisionit; (iii) të zbritet vlera e depozitës 3.129,15 USD në emër të djalit, e hapur fillimisht në datën 18.06.2007, në rubrikën e ndryshimit të likuiditetit. Kjo shumë kishte burim dhuratat për djalin nga të afërmit, familjarët dhe vetë subjekti e bashkëshorti, ndër vite⁵⁴.

10.2. Nga kontrolli i akteve në fashikujt e Komisionit dhe shkaqeve të ankimit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se nuk janë bindëse pretendimet e subjektit në procesin e rivlerësimit, sipas së cilave ajo e bashkëshorti kanë paguar vetëm një pjesë të çmimit të referuar në aktmarrëveshje prej 2.100.000 lekësh, ndërsa pjesa tjetër janë paguar me shërbime ligjore/në natyrë nga bashkëshorti. Edhe duke abstraguuar nga fakti që blerësi ka paguar 30.000 euro [ekuivalenti i përreth 3.700.000 lekëve] për të blerë këtë pasuri, nga gjithë aktet e kohës deduktohet që subjekti e personi i lidhur më së paku duhet të kishin paguar vlerën 2.100.000 lekë, sikurse: (i) referohet nga palët në aktmarrëveshje; (ii) ka deklaruar subjekti në deklaratën periodike; dhe (iii) është rënë dakord në kontratën e premtim shitjes së vitit 2009. Në kushtet që në deklaratat periodike në vijim [për vitet 2008 – 2009], subjekti nuk deklaroi detyrime financiare ndaj shitësit, prezumohet që vlera është paguar e plotë në vitin 2007,

⁵³ Subjekti referon vendimin e Kolegjit (JR) nr. 37/2021, pg. 10.25, që i përket subjektit të rivlerësimit Sokol Ngresi.

⁵⁴ Subjekti sqaron se një deklarim i burimit të kësaj depozite është kryer në ILDKPKI në vitin 2008.

siç rezulton edhe nga përmbajtja e kontratës së premtim shitjes. Ky konkluzion u bazua në analizën që shtjellohet në vijim.

10.3. *Së pari*, pretendimi i subjektit gjatë procesit të rivlerësimit që në analizën financiare ajo të ngarkohet vetëm me një vlerë prej 700.000 lekësh për këtë apartament bie ndesh më gjithë aktet dhe është jobindës. Nga aktet në fashikull rezulton se:

10.3.a. Në deklaratën periodike për vitin 2005, subjekti deklaroi kursime familjare *cash* nga puna 800.000 lekë. Në deklaratën periodike për vitin 2006, subjekti deklaroi 8.000 euro kursime familjare nga të ardhurat.

10.3.b. Në deklaratën periodike për vitin 2007, subjekti nuk deklaroi as shtim e as pakësim të kursimeve. Ajo deklaroi krijimin e kësaj pasurie, vlerën 2.100.000 lekë, por jo burim krijimi. Në deklaratën *vetting*, sikurse sipër-referuar, subjekti nuk ka shprehur burime të tjera për krijimin e pasurisë objekt analize, përveç pagave duke specifikuar edhe vitet përkatëse apo vlerë të ndryshme nga ajo e cituar në kontratë.

10.3.c. Në deklaratën periodike për vitin 2008, subjekti deklaroi krijimin e pasurisë “zyrë”. Si burim të krijimit të saj, subjekti deklaroi kursimet familjare ekzistuese të deklaruara edhe në ILDKPKI.

10.3.d. Në kontratën *noteriale* të premtim shitjes datë 02.06.2009, shitësi [z. Y. M.] dhe bashkëshorti/blerësi kanë rënë dakord për shitjen e apartamentit me vlerën 2.100.000 lekë. Po aty, palët kanë deklaruar se *përveç kësaj vlere*, blerësi do të kryejë shërbime të ndryshme avokatie për një periudhë trevjeçare nga data 21.04.2007 – 21.04.2010. Shitësi, z. M., ka deklaruar se *e ka marrë* shumën e fiksuar që në datën 21.04.2007 dhe tashmë “njeh si pronar të këtij apartamenti” bashkëshortin e subjektit, z. L. K.. Kësaj kontrate i është bashkëlidhur edhe aktmarrëveshja e datës 21.04.2007, hartuar midis të njëjtave palë me të njëjtat parashikime /detyrime, në të cilën, ndër të tjera, citohet se apartamenti është blerë prej shitësit, sipas një kontrate të datës 10.07.2006 dhe likuiduar kundrejt çmimit prej 30.000 eurosh.

10.3.e. Sipas procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI në prill 2015, subjekti ka deklaruar se burim i krijimit të pasurisë është *aktmarrëveshja e vitit 2007* dhe se shuma 700.000 lekë është paguar në dorë për vitin 2007, ndërsa pjesa tjetër është shlyer si kompensim me punën e bashkëshortit si përfaqësues në disa procese gjyqësore. Në dosje është administruar edhe një deklaratë tjetër noteriale e shitësit, datë 28.10.2022, që, ndër të tjera, deklarohet se për shkak se nuk po regjistrohej prona, ndërkohë që blerësi ofronte shërbime ligjore, u ra dakord që edhe pjesa tjetër e çmimit të shlyhej nëpërmjet shërbimeve ligjore.

10.3.f. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në Komision, subjekti dha të njëjtat shpjegime si në ILDKPKI në prill 2015, duke shtuar edhe që nga të ardhurat nga puna u paguan “në dorë” 700.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër u shlye nëpërmjet shërbimeve të avokatisë nga bashkëshorti, me faturat nga viti 2008 – 2015. Këto dy pjesë detyrimesh [që sipas subjektit janë 700.000 lekë dhe shërbimet e përfaqësimit ligjor nga bashkëshorti i saj], së bashku arrijnë në masën 2.944.095 lekë. Po gjatë hetimit administrativ, subjekti depozitoi edhe një shkresë të titulluar “akt rakordim” të datës 14.06.2022, të mbajtur midis bashkëshortit të saj dhe shitësit, si dhe deklaratën noteriale të këtij të fundit, që mban datën 31.01.2022. Në “akt rakordim”, përpos vlerësimeve personale [tejet pozitive] për kontributin e shquar profesional të bashkëshortit të subjektit në zgjidhjen e disa konflikteve familjare, por jo vetëm, deklaruesi prezanton një kalendar pagesash të ri. Konkretisht, pas pagesës 700.000 lekë në datën 04.04.2007, ai shprehet se pjesa e mbetur e detyrimit është shlyer pjesë-pjesë në dy vitet në vijim dhe përfundimisht

finalizuar në dhjetor 2015, nëntë vite më pas. Sjellim në vëmendje që, sipas këtij akti, vlera monetare ekuivalente e apartamentit nga një mbledhje aritmetike rezulton në 2.944.095 lekë⁵⁵.

10.4. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti ka ndryshuar përshkrimin e mënyrës së pagesave dhe çmimin, duke pretenduar një mënyrë të ndryshme krijimi të kësaj pasurie mes deklaratave periodike dhe atë *vetting* nga njëra anë dhe deklarimit gjatë kontrollit në prill 2015 në ILDKPKI dhe në hetimin administrativ, nga ana tjetër. Ky i fundit është haptazi i ndryshëm nga çfarë palët kanë dakordësuar në kontratën e premtim shitjes në shkurt 2009 [referuar më sipër në paragrafin 10.3.d], sipas së cilës pagesa 2.100.000 lekë është kryer që në prill 2007, dhe shërbimet e avokatisë janë përpos/si shtesë mbi këtë pagesë. Ky detyrim, i reduktuar dhe shlyer nëpërmjet shërbimeve të avokatisë, bie ndesh edhe me çmimin e blerjes së apartamentit nga shitësi, nëntë muaj më herët, në korrik 2006, që do të ishte ekuivalenti i 3.700.000 lekëve. Sipas subjektit, apartamenti ishte i mobiluar; ky fakt paraqet rëndësi për të çmuar diferencën mes vlerës së paguar dhe asaj që ka shpenzuar shitësi pak muaj më herët.

10.5. Në kushtet që të ardhurat e kursyera e deklaruara në vitet pararendëse janë deklaruar si burim për pasurinë tjetër, trupi gjykues vlerëson se qëndrimi i Komisionit, për t'u bazuar në përlllogaritjen e burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në deklaratat periodike vjetore e deklaratën *vetting*, është i bazuar. Nga ana tjetër, shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ⁵⁶ dhe në ankim, me qëllim dhënien vlerë provuese versionit të paraqitur prej saj gjatë hetimit administrativ dhe deklarimeve të shitësit në të njëjtën kohë – në shkresën e titulluar “akt rakordim” apo argumentimet për leximin e kontratave noteriale në mënyra të ndryshme nga sa rezulton qartë nga përcaktimi i palëve, përkundër aktmarrëveshjes së vitit 2009, janë të pabazuara, përpos që edhe me probleme të theksuara besueshmërie.

10.6. Konkretisht, pyetjeve *kur* është kryer dhe *sa* ka qenë pagesa, në aktmarrëveshje, nga leximi i deklaratës periodike të vitit 2007 dhe nga kontrata noteriale e premtim shitjes e shkurtit 2009 – tri akte të kohës – rezulton se: (i) palët janë shlyer për vlerën e plotë monetare prej 2.100.000 lekësh; (ii) bashkëshorti i subjektit/blerësi njihet si pronar; si dhe (iii) detyrimi i mbetur do të shlyhej me shërbime avokatie tre vitet në vijim, deri në 2010. Leximi i deklaratës periodike vjetore për vitin 2007, dorëzuar në 26 mars 2008, konfirmon krijimin e pasurisë, pagesën e plotë të vlerës 2.100.000 lekë dhe në mungesë të detyrimeve të prapambetura, konfirmon sa më sipër. Ky variant është në linjë me deklaratën *vetting*, ku subjekti jep të njëjtën vlerë të apartamentit, referon si akt krijimi aktmarrëveshjen e vitit 2007, dhe deklaroi si burim të ardhurat në vitet 2005 dhe 2006 dhe të avokatisë së bashkëshortit nga puna e viteve 2005 dhe 2006, sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 20.10.2016, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Përkundër këtyre akteve të kohës, duke filluar nga prilli 2015, kur është pyetur nga ILDKPKI-ja për disa pasuri dhe mënyrën e pagesës, si dhe gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar versionin e pasqyruar në “akt akordimin” e vitit 2022, sipas së cilit në vitin 2007 është paguar vetëm 700.000 lekë dhe shërbimet e avokatisë kanë vazhduar deri në vitin 2015 (sipas faturave të lëshuara nga bashkëshorti i subjektit).

10.7. Në këto kushte, edhe në Kolegj, analiza u krye për të kontrolluar mundësinë e shlyerjes së vlerës 2.100.000 lekë në vitin 2007, bazuar në aktet e kohës [referuar më sipër] dhe në deklaratën

⁵⁵ Konkretisht, përpos 700.000 lekë [prill 2007] + 544.095 lekë [ekuivalent i 4.500 euro në dhjetor 2007] + 700.000 lekë në 24 dhjetor 2008 + 200.000 në 11 shtator 2009 + 200.000 në 18 dhjetor 2009 + 600.000 lekë në 1 dhjetor 2015 = 2.944.095 lekë.

⁵⁶ Në përmbushje të barrës së provës, subjekti ka argumentuar, ndër të tjera, se aktmarrëveshja e vitit 2007 nuk ka përcaktuar nëse është paguar ndonjë vlerë në çastin e nënshkrimit dhe ka kontestuar modalitetet për mënyrën e kryerjes së pagesës. Subjekti, po ashtu, pretendon se kjo aktmarrëveshje nuk ka vlerë ligjore për të drejtat pasurore të pritshme të saj, pasi nuk sjell pasojë mbi pronësinë, sikurse edhe argumente të tjera në këtë linjë.

vetting, duke theksuar vlerën provuese të deklaratave periodike dhe kontratës noteriale të palëve. Si pasojë e kësaj analize, subjekti rezulton me pamundësi për kryerjen e pagesës dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera për periudhën 1 janar-21 prill 2007⁵⁷. Komisioni nuk ka kryer asnjë analizë të mirëfilltë financiare për këtë pagesë, qoftë në vendim, ashtu edhe në rezultatet e hetimit, duke mos njohur asnjë të ardhur dhe konsideruar gjithë shumën e paguar si balancë negative. Pavarësisht nga kjo mungesë, nga kontrolli i vendimit të Komisionit në Kolegj, konfirmohet konkluzioni se subjekti ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Ky konkluzion qëndron edhe qoftë për shlyerjen e pagesës 2.100.000 lekë, ashtu edhe për 700.000 lekë më 21.04.2007, me të ardhurat e përpjesëtuara deri në atë moment për viti 2007. Balanca negative e kryer për të shteruar të gjitha këndvështrimet e mundshme, duke përfshirë të ardhurat për periudhën dhe zbritur shpenzimet e jetesës do të ishte (-) 1.809.883 lekë; në rastin më të favorshëm për subjektin – ose duke pranuar *hipotetikisht* pagesën e vlerës së reduktuar prej 700.000 lekësh – do të ishte (-) 410.000 lekë (rrumbullakosur).

10.8. Për sa i përket kërkesës së subjektit për të përllogaritur të ardhurat e bashkëshortit të llogariten në vlerën 2.805.112 lekë, 80% e të ardhurave, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje disa aspekte. *Së pari*, subjekti *nuk* ka deklaruar asnjëherë se ka përdorur të ardhurat e vitit 2007 ose ndonjë pjesë të tyre, për krijimin e kësaj pasurie – duke ia atribuar atë të ardhurave të viteve 2005 dhe 2006. *Së dyti*, nga deklaratat periodike vjetore për vitet 2005-2007, rezulton se subjekti ka deklaruar 800.000 lekë kursime gjatë vitit 2005, kursime 8.000 euro të depozituara në bankë nga viti 2006, si dhe asnjë kursim/pakësim apo shtesë *cash*-i për vitin 2007. *Së treti*, kursimet e vitit 2006 [në euro] *nuk* janë tërhequr në vitin 2007, ndërsa në deklaratën për vitin 2008 të gjitha kursimet janë deklaruar të destinuar e përdorura për zyrën, që analizohet në vijim. Për rrjedhojë, gjatë kontrollit të analizës së Komisionit, detajuar më sipër, versioni që përllogarit të ardhurat e bashkëshortit në mënyrë përpjesëtimore⁵⁸ për periudhën janar-prill është në vetvete versioni më i favorshëm i mundshëm, pasi është një ushtrim që merr në konsideratë pretendimet e saj në proces, pavarësisht nga mospërputhjet e tyre me aktet e kohës. Në këtë linjë dhe duke ndjekur këtë alternativë, pretenduar nga subjekti, se nuk ka deklaruar shtesa e pakësime pasi kursimet janë përdorur e riakumuluar në të njëjtën vlerë brenda vitit [2007], subjekti do të rezultonte *gjithsesi* me pamundësi financiare për pagesën e 2.100.000 lekëve me kursimet *cash* të deklaruara në vitin 2005 dhe të ardhurat deri në prill⁵⁹, por edhe për zëvendësimin e së njëjtës vlerë në periudhën që mbetet [22.04.2007 -31.12.2007]⁶⁰, për të përmbushur kështu panoramën, sipas së cilës kursimet në fund të 2007 ishin njësoj me në fund të 2006, e, për pasojë, pa detyrim për deklarim.

10.9. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që kërkimet e subjektit për të zbatuar atë që ajo konsideron si analizë alternative – duke kërkuar që përllogaritja të kryhet, jo vetëm për një vlerë të reduktuar të pagesës, por të shtrihet duke përfshirë të ardhurat e gjithë vitit 2007 për këtë qëllim – është e pakuptimtë dhe qartazi materializim i përpjekjeve të subjektit për të ndryshuar faktet në funksion të nevojës. Subjekti nuk mund të pretendojë se nuk di me siguri nëse pagesa

⁵⁷ Në deklaratën periodike për vitin 2008, subjekti ka deklaruar përdorimin e kursimeve “familjare ekzistuese të deklaruara në ILDKPKI” në funksion të investimit në pasurinë tjetër [zyrë], analizuar në vijim.

⁵⁸ Ose 1/3 e të ardhurave, në totalin 650.000 lekë deri në prill 2007 dhe 1.950.000 lekë deri në fund të vitit, llogaritur sipas një marzhi fitimi prej 65% mbi qarkullimin e konfirmuar nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit.

⁵⁹ Përkatësisht në vlerën (-) 410.257 lekë, nëse përfshihen të ardhurat janar-prill 2007 që në total arrijnë në vlerën (rrumbullakosur) 950.000 lekë dhe kursimet e akumuluar sipas deklaratimeve përfshi kursimet e vitit 2005 në vlerën 800.000 lekë. Duke zbritur nga kjo vlerë shpenzimet e jetesës, ato të arsimimit dhe të udhëtimit (në total 385.000 lekë, rrumbullakosur) dhe 2.100.000 lekë pagesa/parapagesa e apartamentit.

⁶⁰ Kjo analizë do të passillte një balancë negative të burimeve të ligjshme për zëvendësimin e kursimeve në vlerën (-) 875.787 lekë deri në fund të vitit 2007.

është kryer në datën 21.04.2007 apo në fund të vitit, më së paku sepse ka qenë subjekt deklarues dhe ka mjaftueshëm akte të kohës, në të cilat [referuar më sipër] në momentet e hartimit të të cilave duhet të ketë pasur qartësi për sa është paguar dhe kur, edhe duke abstraguar nga formimi profesional i saj dhe bashkëshortit. Duke pretenduar alternativa, kërkimi i saj duket thjesht një përpjekje për të ndryshuar rezultatin negativ financiar. Për më tepër, në kushtet që në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit të viteve 2005-2006, këto kërkime të subjektit nuk u gjetën të bazuara dhe as të kuptimta. Për të njëjtën arsye, edhe pretendimi për *harresë* në mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të të ardhurave të vitit 2007, si burim krijimi i kësaj pasurie, vlerësohet njësoj i pakuptimtë. Subjekti rezulton të ketë ndryshuar pretendimet sipas rastit e nevojës gjë që e bën të pabesueshëm deklarimin e munguar të detajeve me rëndësi për shkak harrese apo ngarkese.

10.10. Në përmbledhje të sa më sipër, nga aktet rezulton se shërbimet e përfaqësimit ligjor të kryer nga bashkëshorti janë *përtej* vlerës së apartamentit – që duket se përkon me faktin që i njëjti apartament i kishte kushtuar shitësit 30.000 euro rreth nëntë (9) muaj më herët. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit nuk i vlerësoi bindëse pretendimet e subjektit se kontradiktat në deklarime u shëruan në deklaratimet në vitin 2015, në ILDKPKI. Ky deklaram, i pashoqëruar me prova dhe në kundërshtim me aktet e kohës, mbetet në nivel deklarativ dhe, si i tillë, është i drejtë konkluzioni i Komisionit. Subjekti ka bërë përpjekje për të pasqyruar në mënyrë të pasaktë pasurinë/vlerën e saj, në kuptim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

10.11. Nga kontrolli i analizës së kryer në Kolegj, ashtu si edhe në Komision, u konfirmua mungesë e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, qoftë për pagesën e vlerës prej 2.100.000 lekësh, sikurse referohet në akte dhe në deklaratat vjetore të kohës, e që vjen në harmoni me veprimet e pranuar nga palët dhe me vlerën e pasurisë nga çmimi i paguar nga shitësi. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Sikurse edhe në Komision, në vlerësimin e kryer në Kolegj, kursimet e deklaruara në deklaratat periodike të viteve 2005 dhe 2006 u përlllogaritën në funksion të krijimit të pasurisë njësi/zyrë [analizuar në vijim], në linjë me pretendimin e subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, edhe nëse përlllogariten në përpjesëtim të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti në periudhën kohore deri në pagesën e pasurisë, në prill 2007, ato janë të pamjaftueshme për të përballuar pagesën.

B.2.III. Pasuria “njësi/zyrë” me sipërfaqe 74,5 m², në bulevardin “{***}”, Tiranë

11. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi pronësinë e kësaj pasurie, me vlerë 8.940.000 lekë dhe burime të krijimit: (i) të ardhurat e bashkëshortit nga puna për vitet 2006, 2007 dhe 2008; (ii) gjendjen 9.000 euro në llogarinë bankare të bashkëshortit; (iii) gjendjen *cash* 21.000 euro, të depozituar në bankë nga e ardhurat e bashkëshortit si avokat; (iv) 10.000 euro hua nëpërmjet veprimit bankar të datës 30.05.2008 nga z. K. Ç.; (v) 21.000 USD dhe 13.800 euro hua nga kunati [z. A. K.]; si dhe (vi) 7.980 GBP hua nga z. A. M.. Në konkluzion, pasi pranoi disa nga shpjegimet e subjektit në rezultate të hetimit, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti dhe bashkëshorti nuk provojnë me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, duke rezultuar me një pamundësi në vlerën (-) 6.355.782 lekë, që e vendos subjektin në parashikimet e pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, Komisioni u bazua në konstatimin për balanca negative për krijimin e secilit prej burimeve të deklaruara, përfshirë ato nga punësimi i bashkëshortit apo nga tri huat e marra. Për njërën prej huave, Komisioni konstatoi edhe ndryshimin e burimit nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ.

11.1. Subjekti kundërshton në tërësi konkluzionet e Komisionit. Përpos pretendimeve të analizuara e shtjelluara gjerësisht më sipër me fokus të drejtat e procesit të rregullt, në shkaqet e ankimit për këtë pasuri, në drejtim të themelit argumentet e saj konsistojnë në kontestimin e analizës së Komisionit për burimin e krijimit të shumës prej 21.000 eurosh, depozituar nga bashkëshorti, për huan prej përreth 25.000 eurosh nga kunati, për huan në vlerën 10.000 euro nga një person tjetër [K. Ç.] dhe për huan në shumën përreth 10.000 euro nga një person tjetër i rrethit familjar të zgjeruar [i fejuari i mbesës së bashkëshortit]. Konkretisht, subjekti pretendon se:

11.1.a. Shuma 21.000 euro e depozituar, e cila, sipas deklarimeve të subjektit, është krijuar nga kursimet *cash* të viteve të mëparshme dhe të ardhurat e vitit 2008 deri në datën e depozitimit të shumës, duhet konsideruar si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë shkak ankimi. Ka deklaruar saktë të ardhurat e bashkëshortit në vitet 2006-2008 në deklaratën periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*. Komisioni ka gabuar duke mos përfshirë të ardhurat e bashkëshortit nga disa shoqëri tregtare, të cilat ajo i ka deklaruar. Për shlyerjen e detyrimeve tatimore, ajo gjendet në kushtet e pamundësisë së sigurimit të dokumentacionit⁶¹, referuar shkresës nr. {***} prot., datë 20.10.2022, së organit tatimor. Në analizën financiare duhet të përfshihen kursimet e deklaruara në deklaratën periodike vjetore për vitin 2004 prej 600.000 lekësh, të cilat janë të mbartura nga viti 2003, por nuk janë deklaruar në deklaratën fillestare për shkak të “mungesës së eksperiencës”.

11.1.b. Ka provuar mundësinë e kunatit për të dhënë hua nga të ardhurat e dokumentuara nga punësimi në Mbretërinë e Bashkuar dhe më pas në “Intesa San Paolo” Bank. Vlerat janë transferuar me transaksione bankare. Shpenzimet e jetesës së kunatit në Angli kanë qenë më të ulta sesa standardi i EUROSTAT-it.

11.1.c. Konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen e huas 10.000 euro nga një individ i dytë/person tjetër i lidhur [nga K. Ç.] është i padrejtë dhe në vlerësim të gabuar të provave. Kjo hua është deklaruar dhe shlyerja e saj në formën e shërbimeve të përfaqësimit ligjor ofruar nga bashkëshorti si person fizik është deklaruar korrektësisht në deklaratën periodike të vitit 2008. Për këtë shumë bashkëshorti i ka paguar detyrimet tatimore, sikurse provohet nga dokumentacioni i depozituar në Komision. Mundësia financiare e huadhënësit në datën 03.05.2008, provohet nga fakti se në llogarinë bankare të këtij personi dhe bashkëshortes së tij është disbursuar një kredi personale në datën 11.05.2007 në vlerën 50.000 euro, e cila është tërhequr krejtësisht nga llogaria në datën 14.05.2007.

11.1.d. Konkluzioni i Komisionit për huan e tretë [nga A. M.] është i pabazuar në provat e depozituara prej saj. Komisioni është treguar paragjykes dhe kontradiktor. Subjekti kërkon nga Kolegji që të vlerësohen provat e depozituara në Komision mbi të ardhurat e gjeneruara nga z. A. M. dhe familjarët e tij, nga verifikimi i të cilave rezulton mundësi financiare për dhënien e huas.

11.2. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykes i Kolegjit konkludoi se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë objekt analize, në vlerën 8.940.000 lekë, në qershor 2008, parashikuar në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht nga korrektimet e kryera në Kolegji, balanca negative e burimeve të ligjshme, ndonëse u zbut, gjithsesi mbetet. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim, duke ndjekur

⁶¹ Subjekti referon vendimin e Kolegjit (JR) nr. 6/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysen Keta.

rendin e burimeve të deklaruara, konkluzioneve përkatëse të Komisionit dhe shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti për secilin burim, sikurse përmbledhur më sipër.

11.3. *Së pari*, nga aktet rezulton se në datën 15.06.2008, personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti dhe premtuesi i shitjes [z. A. K.], nënshkruan kontratën noteriale për “*kalim kredie dhe premtim shitjeje*”, për kalimin e posedimit të zyrës, kundrejt vlerës 8.940.000 lekë.

11.4. Në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti deklaroi krijimin e kësaj pasurie, dhe që pagesa e saj është përballuar me kursime familjare ekzistuese të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore, të ardhurat e fituara deri në momentin e kontratës, si dhe hua nga persona fizikë. Në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti deklaroi tri huat e sipër-referuara, duke specifikuar edhe datat që përkojnë me konfermat bankare në momentin e marrjes së shumës hua. Po ashtu, nga aktet rezulton se në datën 21.05.2008, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit depozitoi në llogarinë e tij bankare në “Intesa San Paolo” Bank, shumën 21.000 euro.

11.5. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konkludoi se subjekti gjendet në kushtet e pamundësisë së krijimit të një depozite prej 21.000 eurosh në datën 21.05.2008 dhe ka një balancë negative në masën (-) 743.929 lekë, për shpenzimet dhe investimet në atë datë. Në këto kushte, Komisioni nuk e përfshiu vlerën 21.000 euro në burimet e ligjshme të krijimit të zyrës. Ky konkluzion ishte rezultat i vlerësimit të Komisionit për kursimet/gjendjen *cash* të deklaruar për vitin 2004 dhe një punësim të pretenduar të bashkëshortit të subjektit në dy persona juridikë privatë [{***} dhe {***}], gjendjen *cash* të deklaruar për vitin 2005 dhe për të ardhurat e pretenduara të fituara gjatë vitit 2008 nga punësimi i bashkëshortit në {***} Sh.A.

11.6. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se qëndrimi i Komisionit është i bazuar. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë burimesh për krijimin e depozitës prej 21.000 eurosh në maj 2008. Balanca negative e përfutur në Kolegj është më e ulët, në një vlerë të papërfillshme, e konkretisht (-) 693.974 lekë kundrejt vlerës (-) 743.929 lekë. Kjo balancë është rezultat i zbritjes së vlerës së depozitës dhe shpenzimeve në periudhën janar-maj 2008 nga të ardhurat dhe kursimet e dokumentuara nëpërmjet akteve të kohës (deklaratat periodike vjetore dhe të ardhurat sipas akteve)⁶².

11.7. Në këtë konkluzion, paraqet rëndësi që edhe në analizën e kryer në Kolegj, nga leximi harmonik i deklaratave periodike me relevancë për këtë shkak ankimi, rezulton se nga kursimet *cash* të deklaruara deri në maj 2008 në deklaratat periodike vjetore, vetëm ato që i përkasin vitit 2005, në vlerën 800.000 lekë, mbulohen me burime të ligjshme⁶³. Kërkimi i subjektit në ankim që të konsiderohet e mbartur nga viti 2003 një shumë prej 600.000 lekësh, që sipas saj nuk e ka deklaruar në vitin 2003 për shkak të harresës, është i pabazuar në ligj dhe i pakuptimtë në kushtet që në formularin për vitin 2004 subjekti ka deklaruar shumën 600.000 lekë, në rubrikën ku kërkohet *data dhe viti i krijimit të pasurisë*, duke specifikuar “*janar – dhjetor 2004*”. Për më tepër, pretendimin se në fakt deklarimi në vitin 2004 ka për objekt kursimet e mëparshme,

⁶² *Balanca negative e përfutur, prej (-) 693,974 lekësh është rezultat i zbritjes mes të ardhurave, në vlerën 2.309.138 lekë dhe shpenzimeve në datën 21.5.2008, në vlerën 3.004.113 lekë. Konkretisht, subjekti ka pasur kursime të mbartura cash nga vitet e mëparshme [2005], 800.000 lekë + 173,050 lekë likuiditete bankare të pakësuara + të ardhura të subjektit dhe bashkëshortit, përkatësisht 322,597 lekë dhe 1.013.491 lekë në total = 2.309.138 lekë. Shpenzimet: jetese 170,775 lekë, arsimimi 183,000 blerje me kartë 25,672, udhëtimi 58,936 dhe depozitimi në llogarinë bankare prej 2.564.730 lekë [ekuivalenti i 21.000 eurove] = në total 3.003.113 lekë.*

⁶³ *Konkretisht: në deklaratën periodike të vitit 2004 subjekti deklaroi gjendje cash 600.000 lekë krijuar në periudhën janar-dhjetor 2004; në deklaratën periodike të vitit 2005 subjekti deklaroi “Kursime familjare krijuar nga tërësia e të ardhurave dhe shpenzimeve familjare, cash në vlerë 800.000 lekë”. Në deklaratat periodike për vitet 2006 dhe 2007 subjekti nuk deklaroi kursime cash.*

subjekti e ka ngritur për herë të parë vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit. Si rrjedhojë, ky kërkim i subjektit u vlerësua si përpjekje e saj për të rregulluar situatën financiare, e jo si pasqyrim i së vërtetës.

11.8. Në deklaratën *vetting*, ndër të tjera, për periudhën deri në kryerjen e këtij investimi, subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit si person fizik për vitet 2005-2013 dhe si person juridik për vitet 2014-2016 nga paga dhe fitimet. Po ashtu, ajo ka deklaruar edhe të ardhura nga shërbimet e avokatisë, paguar me çek në datën 18.02.2009 dhe, *së fundmi*, nga paga në shoqërinë {***} Sh.A., për periudhën nëntor 2007-qershor 2008.

11.9. Konkluzioni i Komisionit për të mos përlllogaritur të ardhurat e pretenduara të bashkëshortit të subjektit nga dy shoqëritë "{***}" Sh.P.K dhe "{***}" Sh.P.K, në vitin 2004, është i bazuar. Këto të ardhura nuk kanë gjetur pasqyrim në deklaratat periodike vjetore, në deklaratën *vetting* dhe në asnjë akt dokumentar të kohës, duke u shfaqur për herë të parë në përgjigje të pyetësorit shtesë. Mbi të gjitha, subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion qoftë marrëdhënien e punësimit/konsulencës me këto shoqëri për bashkëshortin, sikurse as edhe përfitim të shumat monetare të pretenduara me ndonjë dokument të kohës.

11.10. Konkretisht, kontrata e thjeshtë midis shoqërisë "{***}" Sh.P.K dhe personit të lidhur, të cilës i është vendosur data 08.06.2004, paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision, referon të ardhura që nuk janë deklaruar në kohën kur pretendohen të jenë gjeneruar. Shkresa e hartuar gjatë rivlerësimit nga i njëjti person juridik⁶⁴, përpos vlerës së kufizuar provuese për shkak të kohës kur është hartuar, nuk përputhet me shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore (në vijim "DRT"), sjellë nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ, që konfirmon se tatimi në burim i këtij personi juridik për vitet 2004-2006 nuk përmban informacion për bashkëshortin e subjektit. Për shkak të këtyre problematikave, këto dy akte, parë nën dritën e pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016⁶⁵, nuk përmbushin kriteret e pranimit si provë, duke mos qenë në pajtueshmëri me aktet që kanë besueshmëri, deklaratat periodike të kohës, deklaratën *vetting* dhe aktet nga institucionet shtetërore.

11.11. I njëjti arsyetim, mbi të njëjtat rrethana faktike e ligjore, vlen edhe për të ardhurat e pretenduara nga shoqëria "{***}" Sh.P.K. Shkresa e datës 11.02.2020 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e dorëzuar nga subjekti në Komision, për tatim në burim të mbajtur nga kjo shoqëri në vitin 2004, nuk përmban të dhëna për të ardhura që mund të kenë indicie për punësimin e bashkëshortit të subjektit. Edhe mandatpagesat nga e njëjta shoqëri, po ashtu dorëzuar gjatë hetimit administrativ për herë të parë, për të provuar përfitim të shumës 1.296.000 lekë nga bashkëshorti në vitin 2004, paraqesin problematika. *Së pari*, për shkak të momentit procedural kur u paraqitën dhe mungesës së konfirmimit të ekzistencës së një marrëdhënieje shërbimi/konsulence nga akte të tjera, këto akte paraqesin provueshmëri të papërfillshme. Në këto kushte, përveçse për to nuk janë paguar tatimet faktikisht, në vijim të

⁶⁴ Shkresa e datës 05.01.2021 e shoqërisë "{***}" ShPK, e cila referon se nga kontrolli i sistemit financiar të shoqërisë për vitet 2004 – 2005, pagesa e personit të lidhur me subjektin për periudhën qershor 2004 – prill 2005, është bërë kundrejt tarifës 1.000 euro në muaj. Po aty, shkresa referon që në zbatim të legjislacionit tatimor është ndaluar vlera 100 euro nga arka. Sipas "ditarit furnitor" referohet se për bashkëshortin e subjektit, në vitin 2004 u paguan 7.000 euro (879.350 lekë), dhe në vitin 2005 u paguan 4.000 euro (504.320 lekë). Subjekti ka sjellë edhe një kontratë të thjeshtë, që mban datën 08.06.2004 mes "{***}" ShPK dhe bashkëshortit për ndihmë juridike me shpërbim mujor 1.000 euro dhe një shkresë të DPT-së, lëshuar në vitin 2021, për tatimin në burim të shoqërisë "{***}" ShPK për periudhën 2004 – 2006.

⁶⁵ "[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. [...]"

arsyetimit të mësipërm përjashtohet edhe teorikisht, përmbushja e kriterit të ligjshmërisë për këto të ardhura të pretenduara.

11.12. Duke vijuar me analizën për ligjshmërinë e të ardhurave, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk ka provuar as që bashkëshorti i saj ishte në një marrëdhënie pune apo i deklaruar nga shoqëritë që pretendon të ardhurat, në mënyrë që detyrimi i pagimit të këtyre vlerave t'i ngarkojë si përgjegjësi punëdhënësit. Ajo ka pretenduar që bashkëshorti kishte marrëdhënie shërbimi/konsulente me këta persona juridikë, që nënkupton që është ai vetë që mbartte detyrimin që të shlyente detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale. Edhe shkresa e DRT-së, datë 07.07.2022, konfirmon që bashkëshorti i subjektit është regjistruar si person fizik në datën 10.05.2005 [deri më 20.06.2014]. Përpara kësaj date, sipas legjislacionit tatimor, të ardhurat e përfituara do të duhet të ishin deklaruar e nënshtruar tatimit mbi të ardhurat personale, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Sa më sipër është në linjë edhe me sa rezulton nga shkresat në fashikull. Konkretisht, shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve e vitit 2017⁶⁶ referon të ardhura të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit për vitet 2005 dhe 2006, por jo për vitin 2004. Për këtë vit, nuk ka as deklarime të këtyre të ardhurave në deklaratat periodike. Në këto kushte, ashtu si në Komision, edhe në analizën e kryer në Kolegj, vlerat e pretenduara të përfituara nga shërbimet e konsulencës në këto dy shoqëri nuk u bënë pjesë e analizës financiare.

11.13. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit se gjendet në kushtet e pamundësisë së sigurimit të dokumentacionit provues të tatimeve janë të pakuptimta, për sa kohë edhe vetë subjekti nuk ka pretenduar se bashkëshorti ka shlyer detyrime tatimore për këto të ardhura apo se aktet janë zhdukur e nuk mund të prodhohen për arsye që janë përtej kontrollit të saj e në ngarkim të institucioneve⁶⁷. Subjekti nuk ka sjellë asnjë akt që të ofronte informacion, qoftë edhe rrethanor, që aktet që provojnë pagesën e tatimeve kanë humbur, janë zhdukur apo nuk mund të prodhohen, përkundrazi. Ajo nuk ka arritur as të provojë ekzistencën e një marrëdhënieje konsulente/shërbimi, sikurse as e ka deklaruar atë deri kur kishte nisur hetimi administrativ. Për rrjedhojë, është i bazuar konstatimi i Komisionit se mosdeklarimi i këtyre të ardhurave në deklaratën periodike ose më së paku në deklaratën *vetting*, u vlerësua në drejtim të mënyrës sesi subjekti ka perceptuar detyrimet për respektimin e ligjit dhe në drejtim të konstatimit të mospërmbushjes së kriterit të ligjshmërisë sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

11.14. Për sa më sipër, në analizën e kryer në Kolegj, janë përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të ardhurat e konfirmuara sipas akteve të administratës tatimore, sikurse edhe në Komision. Për vitin 2005, llogaritja e xhiros, sipas kërkimit të subjektit, nuk do të ndryshonte kursimet e deklaruara për vitin 2005, i cili ka rezultuar me balancë pozitive dhe të ardhurat e kursyera e deklaruara si likuiditet jashtë sistemit bankar janë përfshirë në analizë në mesin e burimeve të ligjshme.

11.15. Për të ardhurat e bashkëshortit nga puna për vitet në vijim, 2006, 2007 dhe 2008, ndër të tjera, subjekti dorëzoi vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë {***} Sh.A, për shpërblimin e bashkëshortit të saj në vlerën 2.000.000 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit përfshiu në analizën financiare në funksion të krijimit të depozitës objekt analize të ardhurat deri në maj

⁶⁶ Datë 20.07.2017 dhe datë 22.08.2017, dërguar ILDKPKI-së nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

⁶⁷ Neni 32 pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon që: “[2.] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.”

2008 që janë konfirmuar si pagesa për shërbimet e konsulencës së bashkëshortit të subjektit pranë këtij personi juridik. Në të njëjtën linjë arsyetimi sikurse edhe Komisioni, në kushtet që Komisioni shprehet se në vitin 2008, të vetmet të ardhura të dokumentuara të përfituara nga personi juridik [***] Sh.A.] deri në maj 2008, janë në vlerën 236.568 lekë, e cila u përfshi në mesin e burimeve të ligjshme. Të ardhurat e pretenduara nga kjo shoqëri në vitin 2007, në kushtet që nuk janë deklaruar si kursime në fund të vitit, nuk u përfshinë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara duke u prezumuar të shpenzuara, nën dritën e ligjit nr. 9049/2003. Të ardhurat e kaluara me çek bankar nga shoqëria {***} Sh.A, datojnë pas datës 21.05.2008, kur u depozitua vlera 21.000 euro në bankë e, si rrjedhim, Komisioni nuk i përfshiu në analizë.

11.16. Në përmbledhje të sa më sipër, edhe në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, subjekti dhe personi i lidhur kanë qenë në kushtet e pamundësisë së krijimit të vlerës të plotë prej 21.000 eurosh në datën e depozitimit të saj [21.5.2008]. Edhe në Kolegj u vlerësua jobindës e i pabazuar pretendimi i subjektit që tenton të lëvizë më herët në kohë, përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 9049/2003, kursimet që ajo vetë ka deklaruar në mënyrë të shprehur se i përkasin periudhës *janar – dhjetor 2004*, në deklaratën periodike vjetore të hartuar në mars 2005. Në kushtet që për herë të parë ky pretendim u ngrit vetëm pasi subjekti u njoh me balancën negative për vitin 2003, me rezultatet e hetimit, ky pretendim u vlerësua si përpjekje e saj për të rregulluar situatën financiare e jo si pasqyrim i së vërtetës.

11.17. Burimi tjetër i krijimit të pasurisë objekt analize është një *hua* e deklaruar e marrë nga *kunati* i subjektit, vëllai i bashkëshortit, z. A. K., në shumat 21.000 USD dhe 12.000 euro (rumbullakosur). Në analizën e kryer për këtë qëllim, Komisioni mbajti në konsideratë që i njëjti familjar i bashkëshortit deklarohet të jetë kontribuuesi kryesor i apartamentit në përdorim të subjektit (analizuar më sipër). Komisioni përjashtoi të ardhurat deri në vitin 2001, kur u ble pasuria/shtëpia në përdorim të subjektit, si dhe zbriti shpenzimet e jetesës së huadhënësit në Britaninë e Madhe, sipas EUROSTAT-it. Të ardhurat e deklaruara u analizuan sipas deklaramit: nga emigracioni deri në vitin 2003, si dhe nga punësimi në Shqipëri për periudhën nga viti 2005-maj të vitit 2008. Në përmbushje të barrës së provës, pas shpjegimeve të subjektit, Komisioni përfshiu në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara nga ky person tjetër i lidhur edhe të ardhura nga punësimi në një hotel në Londër për periudhën prill-gusht 2003. Në konkluzion, Komisioni konstatoi se për periudhën prill 2001-gusht 2003, huadhënësi/kunati është në kushtet e pamundësisë financiare në vlerën (-) 1.455.904 lekë dhe për periudhën në vijim në vlerën (-) 2.171.115 lekë. Për rrjedhojë, Komisioni konkludoi se të ardhurat e pretenduara të marra hua nga kunati nuk duhet të përfshihen në analizën e mundësisë financiare të krijimit të kësaj pasurie.

11.18. Trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim pretendimet e subjektit dhe në një analizë në të cilën vlerësohen në harmoni gjithë faktet e pretenduara nga subjekti në lidhje me kontributin e këtij personi tjetër të lidhur/huadhënësi, në versionin më të favorshëm, huadhënësi do të kishte mundësi të kontribuonte me huadhënien në qershor 2008, në vlerën 21.000 USD e 13.800 GBP, por në pamundësi për të kontribuar në krijimin e apartamentit të analizuar më sipër, në përdorim të subjektit e familjes së saj.

11.19. Nga dokumentacioni bankar rezulton se në datën 02.05.2003, në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, është kryer një transfertë nga Mbretëria e Bashkuar në vlerën 8.000 GBP dhe një depozitim *cash* nga llogarimbajtësi në datën 21.08.2003 në vlerë 10.200 GBP. Në deklaratën e vitit 2003, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se gjendja në llogarinë rrjedhëse [18.146 GBP] janë fonde të vëllait dhe motrës së tij nga puna e tyre në emigracion në Angli. Këto fonde kanë mbetur të ngurtësuara në llogari bankare deri në datën 06.05.2004, kur bashkëshorti i subjektit i ka transferuar vëllait në llogarinë bankare të këtij të

fundit. Këtë vlerë, Komisioni nuk e përfshiu në analizën e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur në funksion të huadhënies për blerjen e zyrës, pasi konstatoi se kunati i subjektit në vitin 2003 kishte rezultuar me pamundësi të krijimit të kësaj vlere dhe, për rrjedhojë, në pamundësi të dhënies së huas me të ardhura nga emigracioni.

11.20. Po nga dokumentacioni rezulton se në datën 12.06.2008, kunati i subjektit/personi tjetër i lidhur ka transferuar në drejtim të llogarisë së palës shitëse të zyrës shumë prej 21.000 USD me përshkrimin “Shlyerje detyrimi”. Në datën 13.06.2008, po i njëjti person, rezultoi të ketë transferuar në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit dy vlera 3.000 GBP dhe 8.067,81 euro. Sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ dhe të konfirmuara nga një deklaratë noteriale e datës 25.10.2022 nga kunati, këto fonde kanë burim të ardhurat e tij nga emigracioni në periudhën shtator 1999-gusht 2003 dhe nga punësimi më pas pranë “Intesa San Paulo” Bank deri në momentin e dhënies së huas.

11.21. Komisioni ka konstatuar pamundësi për krijimin e kësaj vlere me burime të ligjshme nga huadhënësi, në një balancë negative prej (-) 1.455.904 lekësh. Nga kontrolli i vendimit në Kolegj, balanca negative do të ishte e përafërt në vlerën (-) 1.432.622 lekë. Nga ana tjetër, duke mbajtur në konsideratë që kjo shumë iu rikthye huadhënësit/kunatit të subjektit në vitin 2004, sikurse edhe arsyetimin në vendime të mëparshme për kufijtë e hetimit të personave të tjerë të lidhur, nën dritën e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, analiza e personit tjetër të lidhur në Kolegj u krye në alternativën e bazuar në metodën e thjeshtë, pa përfshirë investime, pasuri apo likuiditete të tjera. Me këtë qasje, duke e përlllogaritur vlerën e kthyer mbrapsht atij nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2004, ky person tjetër i lidhur do të rezultonte me mundësi për të kontribuar me huan në vlerën 21.000 USD në datën 12.06.2008 dhe 13.800 euro në datën 13.06.2008, nga të ardhurat e periudhës prill 2001 - maj 2008. Në të njëjtën qasje, ky person tjetër i lidhur do të rezultonte në *pamundësi* për të kontribuar në krijimin e apartamentit të analizuar më sipër, në përdorim të subjektit e familjes së saj.

11.22. Në analizën e shtjelluar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shpenzimet e jetesës së kunatit në Britaninë e Madhe, Komisioni i ka përlllogaritur në nivel varfërie, sipas EUROSTAT-it. Duke qenë këto shpenzimeve në nivele minimale, korrigjimet e pretenduara nga subjekti nuk gjejnë zbatim. Edhe në analizën e kryer nga Kolegji, u përdorën të njëjtat referenca zyrtare, ndërsa pretendimet e subjektit u vlerësuan në linjë me çështje të mëparshme, si të pabazuara, sikurse trajtuar edhe më sipër⁶⁸.

11.23. Burimi tjetër i deklaruar për krijimin e pasurisë objekt analize është një *hua* në shumë 10.000 euro nga aktiviteti tregtar i z. K. Ç.⁶⁹. Komisioni konkludoi se z. K. Ç. ka qenë në mungesë të burimeve të ligjshme të huadhënies 10.000 euro dhe nuk e përfshiu këtë vlerë në analizën e të ardhurave që shërbyen për krijimin e zyrës në vitin 2008. Në vendim, Komisioni arsyetoi se të ardhurat nga një kontratë kredie e marrë nga ky person tjetër i lidhur dhe bashkëshortja, si burim i huadhënies, u deklaruan vetëm pas rezultateve të hetimit, që përbën ndryshim/shtesë të burimit të të ardhurave gjatë procesit. Për pasojë, ky pretendim nuk u mor në konsideratë. Komisioni vlerësoi se subjekti nuk është bindëse në shpjegimet dhe provat e

⁶⁸ Subjekti kërkon edhe që shpenzimet e jetesës në Britaninë e Madhe të përlllogariten më të ulëta pasi kunati ishte emigrant, jetoi tek e motra dhe shpenzonte 2.527,2 GBP në vit. Subjekti kërkoj të merret në konsideratë deklarata noteriale e kunatit dhe të përdoret si referencë sistemi zyrtar i statistikave në UK:

<https://www.ons.gov.uk/peoplepopulationandcommunity/personalandhouseholdfinances/expenditure/datasets/familyspendingeorkbook1detailedexpenditureandtrends>

⁶⁹ Shënuar ekzakhtësisht: “Huadhënësi K. Ç., ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, ka kaluar në llogarinë e L. K. më 30.05.2008, shumë 10.000-euro sipas marrëveshjes bashkëlidhur”.

depozituara, duke mos arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për të ardhurat e huadhënësit që shërbyen si burim i krijimit të vlerës 10.000 euro.

11.24. Përpos sa është përmbledhur më sipër, në ankim, subjekti pretendon se Komisioni ka refuzuar provat në mënyrë të paarsyetuar. Pagesa 10.000 euro është kryer nga administratori i shoqërisë tregtare në kuadër të parapagimit të shërbimeve ligjore që do të ofroheshin nga bashkëshorti i saj për llogari të shoqërisë “{***}” Sh.P.K., me ortak të vetëm z. K. Ç.. Po ashtu, Komisioni nuk mori në analizë shpjegimet e saj se z. Ç. dhe bashkëshortja e tij, në vitin 2007, kishin marrë edhe një kredi prej 50.000 eurosh për qëllime personale.

11.25. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti deklaroi se si burim për krijimin e kësaj vlere kishin shërbyer të ardhurat e z. Ç., i cili ishte ortak dhe administrator i vetëm i shoqërisë tregtare “{***}” ShPK. Të njëjtin shpjegim subjekti e ka dhënë edhe kur është pyetur në ILDKPKI në prill 2015⁷⁰. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, e konkretisht nga të dhënat nga Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim “QKB”) dhe nga të dhënat nga DRT-ja Tiranë, Komisioni ka konstatuar se nuk rezultonte vendim i asamblesë së ortakëve që provon shpërndarjen e dividendit për të mundësuar dhënien e huas subjektit. As kontrolli i pasqyrave financiare të shoqërisë nuk e konfirmon këtë pretendim. Në këto kushte, Komisioni konkludoi se subjekti nuk arriti të vërtetojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e ligjshme të huadhënësit nga aktiviteti tregtar, për huan prej 10.000 eurosh, të dhënë në vitin 2008, dhe i kaloi subjektit barrën e provës.

11.26. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti për herë të parë parashtroi që në fakt shuma e pretenduar dhënë hua ishte parapagim për shërbimet e avokatisë që do të ofronte bashkëshorti dhe potencoi që huadhënësi, qoftë në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK., ashtu edhe si individ kishte mundësi që të jepte këtë vlerë. Subjekti shtoi si burim të fondeve në dispozicion të huadhënësit edhe një kredi në vlerën 50.000 euro, të marrë prej tij e bashkëshortes, për qëllim personal. Subjekti, po ashtu, argumentoi se shpërndarja e dividendit ndjek një procedurë të posaçme, që kushtëzohet nga lëshimi i certifikatës së aftësisë paguese nga administratori.

11.27. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti depozitoi edhe një aktmarrëveshje jonoteriale/të thjeshtë që mban datën 05.06.2008, lidhur midis z. Ç. dhe bashkëshortit të saj. Ky akt ishte depozituar fillimisht në ILDKPKI në vitin 2011, 2015, e më pas bashkë me setin e dokumenteve me deklaratën *vetting*. Në këtë aktmarrëveshje është shënuar se bashkëshorti i subjektit do të përfaqësojë z. Ç. dhe shoqërinë “{***}” ShPK në 12 procese gjyqësore, dhe pavarësisht se vlera u transferua në rrugë bankare e gjitha në vitin 2008, në aktmarrëveshje është shënuar se 3.500 euro konsiderohen të likuiduara për vitin 2008, ndërsa 6.500 euro për vitin 2010. Ndër të tjera, në këtë akt, palët referojnë edhe emrat e gjyqtarëve që gjykojnë/gjykuan mosmarrëveshjet, për të cilat bashkëshorti i subjektit do të përfaqësonte personin juridik në fjalë.

11.28. Nga analiza e sa sipër referuar, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ka disa aspekte që e bëjnë të pabesueshëm pretendimin e subjektit pas rezultateve të hetimit. *Së pari*, në mënyrë të shprehur e të qartë, subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në ILDKPKI që të ardhurat nga është krijuar huaja nuk janë personale, nga kredia e marrë prej tij dhe bashkëshortes, dhe as si parapagim për shërbime që do të kryente në vijim. Në mënyrë konsistente në këto momente, subjekti ka referuar të ardhura të fituara tashmë, në qershor 2008, nga një hua nga aktiviteti tregtar. Në të njëjtën linjë, në një vetëdeklarim të subjektit në ILDKPKI, i protokolluar në datën

⁷⁰ Në përgjigje të pyetjes nr. 4, në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 22.04.2015, subjekti ka deklaruar se z. Ç. e ka krijuar vlerën 10.000 euro nga aktiviteti i tij tregtar.

11.06.2009, subjekti ka deklaruar se shuma 10.000 euro i është dhënë *hua* bashkëshortit nga z. K. Ç., pa referuar kushtëzim të saj me shërbime avokatie dhe pa dorëzuar aktmarrëveshjen e sjellë në vijim, ndonëse data e saj [05.06.2008] është shumë afër në kohë me këtë vetëdeklarim.

11.29. Edhe në këtë rast, trupi gjykues e vlerëson me rëndësi të theksojë mungesën e besueshmërisë së konstatuar në pretendimet e subjektit, arsyetuar më sipër për ndryshimet në deklaratimet e saj për çmimin dhe vlerën e paguar për apartamentin në Golem, të pretenduar si të shlyer më shërbime avokatie të premtuara. Edhe në këtë rast, subjekti potencon një panoramë të ngjashme, në të cilën pretendohen në faza të caktuara shërbime avokatie të premtuara, që nuk janë pasqyruar në akte të kohës. Si të tilla u vlerësuan se paraqesin një nevojë në procesin përkatës më tepër sesa realitetin faktik. Ky konstatim përforcohet më tepër, pasi trupi gjykues vëren se në aktmarrëveshjen e sjellë si provë, e cila datohet 05.06.2008, referohen mosmarrëveshje të cilat *kanë lindur pas* hartimit të saj.

11.30. Me fjalë të tjera, marrëveshja paradaton konfliktet gjyqësore, që vë në dyshim vërtetësinë e kohës kur është hartuar. I tillë është për shembull procesi gjyqësor i shqyrtuar nga gjyqtari A. M., i cili duke pasur datë regjistrimi në tetor të të njëjtit vit [22.10.2008] është materializuar vetëm disa muaj pas marrëveshjes. Në të njëjtën linjë, ndër të tjerë: (i) procesi me paditës L. A. ka datë regjistrimi 08.10.2008; (ii) procesi me gjyqtar N. C. ka objekt “kundërshtimin e vendimit nr. {***} dhe nr. {***}, datë 21.01.2010, të AKKP-së”; (iii) procesi gjyqësor me palë të paditur {***} mban datë regjistrimi 28.06.2010; (iv) procesi gjyqësor me palë të paditur {***} mban datë regjistrimi 31.05.2010; (v) procesi gjyqësor me palë të paditur L. A., përfunduar nga gjyqtar L. F., ka për objekt “kundërshtimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 01.06.2009”.

11.31. *Së fundmi*, në aspektet e mësipërme, trupi gjykues vëren se e pyetur për shlyerjen e detyrimit ndaj z. Ç., në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 24.11.2011, subjekti është përgjigjur se kthimi i detyrimit është bërë nëpërmjet shërbimit të avokatisë në disa procese gjyqësore. Përgjatë viteve 2009 – 2011, subjekti nuk ka deklaruar detyrim të mbetur në favor të huadhënësit.

11.32. Gjithashtu, nga aktet në fashikujt e Komisionit, konstatohet se përpos që nuk u provua se z. Ç. shpërndau dividend, edhe subjekti nuk rezulton ta ketë kontestuar, duke preferuar të referojë procedura të caktuara të shpërndarjes, pa u fokusuar në një shpjegim konkret se kur huadhënësi e ka përfituar në pikën fundore këtë të ardhur, dhe thirri në analizë shërbimet e avokatisë apo fondet nga kredia bankare. Edhe në vlerësimin e trupit gjykues, ndryshimi/devijimi i burimit të të ardhurave të z. Ç. vlerësohet si një shmangie nga rezultati i hetimit administrativ për të përmirësuar situatën financiare. Për këto arsye, edhe disbursimi i kredisë dhe tërheqja e fondeve nëpërmjet saj një vit para dhënies së huas nuk provon disponibilitetin e këtyre fondeve për t’ia dhënë *hua* një vit pas tërheqjes subjektit e personit të lidhur për të blerë njësi shërbimi. Përkundrazi, fakti që bashkëshortët Ç. kanë aplikuar për një kredi në vitin 2007, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk mund të mos përbëjë edhe argument që tregon mungesë likuiditetesh në dispozicion, që i ka detyruar ata të marrin kredi e përballojnë interesat që vijnë me të.

11.33. Për sa arsyetuar, në analizën e kryer në Kolegj [ashtu si edhe në Komision], vlera prej 10.000 eurosh nuk u konsiderua si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë shkak ankimi. Si rrjedhojë e këtij arsyetimi, për *huan* prej 10.000 eurosh [nga z. K. Ç.], si një ndër burimet e krijimit të pasurisë, trupi gjykues konstatoi se subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm, për asnjë nga alternativat e ndryshme të prezantuara prej saj në momente të ndryshme të procesit të rivlerësimit, që variojnë nga të ardhurat nga aktiviteti tregtar, te pagesa për shërbime ligjore e

më pas të ardhurat nga kredia e marrë prej këtij individi e bashkëshortes një vit përpara huadhënies së pretenduar.

11.34. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se ky individ/huadhënësi nuk rezulton të ketë tërhequr dividend nga aktiviteti tregtar, ndërsa pretendimi se huaja ishte në fakt parapagim për shërbime juridike, të cilat do t'i kryente bashkëshorti, është i pabesueshëm në kushtet që aktmarrëveshja e sjellë për këtë qëllim referon 12 çështje gjyqësore specifike, të cilat në datën e hartimit të saj, në qershor 2008, nuk ekzistonin [nuk ishin regjistruar] ende. Për këto arsye, edhe duke abstraguar nga kontradiktat në pasqyrimin e marrëdhënies së vërtetë nëpërmjet të cilës është përfitur shumë prej 10.000 eurosh objekt analize [nëse hua apo shpërbim shpenzimesh ligjore], trupi gjykues vëren se aktmarrëveshja e thjeshtë e qershorit 2008, e sjellë si provë, nuk është e besueshme dhe është qartësisht e kryer për efekt të kontrollit, pasi do të ishte e pamundur që palët të parashikonin saktësisht proceset gjyqësore, emrat e gjyqtarëve apo edhe numrat dhe datat e vendimeve, të cilat datojnë edhe vite më pas. *Së fundmi*, fakti që ky individ ka pasur nevojë të marrë kredi në vitin 2007, provon të kundërtën e gjendjes financiare të shëndetshme që pretendohet si bazë e huadhënies.

11.35. Burimi i fundit i deklaruar është *huaja* prej 7.980 GBP marrë nga një individ tjetër, z. A. M., pjesë e familjes së zgjeruar të bashkëshortit. Komisioni konkludoi se ky huadhënës nuk kishte burime financiare të ligjshme të mjaftueshme dhe pretendimet e subjektit se ai [huadhënësi] ka përdorur edhe të ardhurat e motrës së tij për të dhënë huan nuk janë bindëse.

11.36. Sikurse arsyetuar më sipër, pretendimet e subjektit se Komisioni ishte paragjykses apo nuk mori në konsideratë provat e sjella prej saj është tërësisht i pabazuar. Ky pretendim vlerësohet se është rezultat i qëndrimit përfundimtar për të mos pranuar aktet e sjella rishtazi prej saj, nëpërmjet të cilave, për të kapërcyer mungesën e burimeve të huadhënësit, subjekti u përpoq të argumentojë se huadhënësi me banim në Mbretërinë e Bashkuar, i fejuari i vajzës së motrës së bashkëshortit, për t'i dhënë hua dajës së të fejuarës së tij (bashkëshortit të subjektit) për të blerë njësi/zyrë në Tiranë, mori hua edhe nga e motra. Kjo e fundit, gjithashtu, jetonte e punonte në Mbretërinë e Bashkuar. Ky burim i ri për huadhënien – motra e të fejuarit të mbesës së bashkëshortit -- u paraqit nga subjekti për herë të parë në përgjigje të barrës së provës dhe pretendoi se në përgjigjet në ILDKPKI në vitin 2015, deklaroi si burim i të ardhurave të z. M., të ardhurat nga puna dhe kursimet e tij familjare.

11.37. Në kushtet që të gjitha pretendimet, që lidhen me arsyetimin e vendimit të Komisionit për këtë aspekt, janë analizuar gjerësisht më sipër dhe konstatuar të pabazuara, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga kontrolli i ushtruar mbi themelin e argumenteve, konkluzioni i Komisionit u konfirmua. Në kushtet që të ardhurat e motrës së personit *tjetër* të lidhur nuk janë deklaruar nga subjekti si burim për krijimin e huas, as në deklaratën e pasurisë *vetting* e as në përgjigje të pyetësorëve, ashtu sikurse ka arsyetuar Komisioni, edhe Kolegji vlerëson se pranimi i tyre do të përbënte deformim të deklaramit të kryer nga subjekti. Për më tepër, vlerësohet i drejtë edhe konstatimi i Komisionit se subjekti nuk është bindëse në pretendimin që i fejuari i vajzës së motrës së bashkëshortit të saj, përveç të gjithë të ardhurave të tij, përdori edhe të ardhurat e motrës së tij, për të dhënë një hua, për të blerë një pasuri të dytë, për një investim jo jetik, kritik apo urgjent, sikurse ishte blerja e një zyre në qendër të Tiranës, me vlerë të konsiderueshme [8.900.000 lekësh], ndërkohë që një vit më parë kishte investuar edhe në një shtëpi plazhi në Golem.

11.38. Nga dokumentacioni bankar që gjendet në dosje rezulton se në datën 28.05.2008, në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit, është transferuar nga huadhënësi vlera 7.980

GBP. Sipas vërtetimit datë 16.10.2020 të Zyrës së të Ardhurave dhe Taksave, në Mbretërinë e Bashkuar, deri në muajin gusht 2008, huadhënësi ka përfituar të ardhura *bruto* të taksueshme në vlerën 12.142,61 GBP dhe 360 GBP, nga ku mund të përlllogariten të ardhurat *neto* pas zbritjes së ndalesave në vlerën 10.293,65 GBP. Në fashikull nuk ka akte për të ardhura të tjera të përfituara prej tij në atë vend.

11.39. Duke përlllogaritur sa konfirmuar më sipër, në analizën e kryer në Kolegj, të ardhurat e z. M. për periudhën janar – maj 2008 u përlllogaritën në mënyrë proporcionale në total në vlerën 6.433,5 GBP. Nga kjo analizë e të ardhurave të dokumentuara, rezultoi se z. A. M. nuk kishte mundësi financiare për kryerjen e transfertës prej 7.980 GBP, edhe *pa llogaritur shpenzime jetese*. Këto shifra marrin rëndësi akoma më të spikatur parë edhe në kontekstin e arsytuar më sipër për besueshmërinë e arsyeve, përse ky individ do të duhet të jepte një hua që *kapërcente* edhe të ardhurat e deriatëhershme të vitit, për të financuar një hua për një investim jo kritik e as urgjent të dajës së të fejuarës së tij, në një balancë mes nevojave personale të tij dhe ato të huamarrësit. *Së fundmi*, në linjë me qëndrime të mëparshme të Kolegjit⁷¹, analiza e burimeve të ligjshme të disponuara nga huadhënësi nuk u shtri edhe te burimi i ri i pretenduar, hua e tij nga e motra, në kushtet që ka ardhur për herë të parë në një fazë të avancuar të hetimit administrativ.

11.40. Në përmbledhje e si konkluzion i sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, nuk i gjeti bindëse shpjegimet e pretendimet e subjektit për huan nga z. A. M., që përfaqëson një lidhje të prezumuar familjare të *kunatës* së saj. Në kushtet që pretendohet që z. M. përdori edhe të ardhurat e motrës së tij për t'i dhënë hua bashkëshortit të subjektit, ndërsa jo vetëm lidhja është e largët [në momentin e huadhënies referohet si *i fejuari i mbesës së bashkëshortit* të subjektit], por të ardhurat e motrës së huadhënësit janë parashtruar si burim financimi i huas për herë të parë, pasi subjekti është njohur me rezultatet e hetimit administrativ. Në kushtet kur subjekti nuk arriti të justifikojë me dokumentacion ligjor të kohës mundësinë financiare të këtij huadhënësi për të financuar huan, këto të ardhura nuk u përfshinë në analizën financiare të mundësisë së krijimit të pasurisë.

11.41. Përfundimisht, nga kontrolli i analizës së kryer në Kolegj, subjekti dhe personi i lidhur rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për blerjen e *pasurisë “njësi/zyrë”*, me sipërfaqe 74,5 m², në Tiranë, në një vlerë më të ulët [(-) 2.965.566 lekë] sesa ajo e referuar në vendimin e Komisionit, që pavarësisht nga zbutja, është *e konsiderueshme* edhe pas korrektiveve të kryera në Kolegj. Për rrjedhojë, edhe për këtë pasuri, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

12. Në përfundim, në analizë të shkaqeve të ankimit dhe nën dritën e përcaktimeve të pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të tjera.
13. Në këto kushte, pas reflektimit të konkluzioneve të sipërcituara, nën dritën e pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk është i besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm. Për këto arsye, vendimi nr. 587, datë 22.11.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, është i mbështetur në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

⁷¹ *Shih vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Bernina Kondi (JR) nr. 37/2022 [pg. 25.3]; Arjan Qafa (JR) nr. 19/2023 [pg. 59.1, 59.2, 60]; Elbana Lluri (JR) nr. 26/2022 [pg. 18.7], ndër të tjerë.*

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 587, datë 22.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Teuta Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 08.07.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi